

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XIX i botimit, nr. 221, Mars 2022
Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

Shkollimi e edukimi janë çelësi i emancipimit të shoqërisë sonë

"Përparimet tua kënaqësi për prindërit, frymëzim për shoqërinë. Ju jeni e ardhmja e jonë!", ishte tema e veprimtarisë së radhës që Shoqata Atdhetare "Dukagjini" zhvilloi me datën 13 mars 2022, në mjedisin e shkollës "Edit'h Durhami", me qëllimin kryesor, që nëpërmjet këtij takimi, të japim mesazhin apo të tërheqim vëmendjen, se vetëm shkollimi të emancipon e të hap rrugën të ecim përpara në jetë. Gjatë veprimtarisë u vlerësuan 31 nxënës të ekselencës të klasave të nënta të disa prej shkollave 9-vjeçare të qarkut Shkodër. Në këtë veprimtari përveç nxënësve u vlerësuan edhe 7 mësues për punën e bërë në edukimin e brezave. **2**



PROBLEME TË GJUHËS SHQIPE

Gjuha shqipe ka kaluar një etapë të gjatë të zhvillimit të sajë. Ajo sot është shumë e rrezikuar nga përdorimi i panevojshëm i fjalëve nga gjuhët e huaja edhe kur ato i kanë të barabartat e tyre në gjuhën shqipe. Problemin e përdorimit të fjalëve nga gjuhët e huaja në të folurën shqipe e kanë ngritur qysh në shekullin e XVII Pjetër Bogdani dhe kontribuuesit e tjerë të ruajtjes së sajë.

Gjatë shekujve të parët tanë e ruajtën gjuhën e tyre pavarësisht se ajo formën e plotë të sajë e mori në Kongresin e Manastirit në vitin 1908. Sot asaj i kanoset një rrezik i dyfishtë, asimilimi nga përdorimi i panevojshëm i fjalëve të huaja dhe përdorimi pa kriter i dialekteve të ndryshme në punimet e shkruara dhe të publikuara.

Nisur nga këto fakte, është detyrë e të gjithë popullit shqiptar, por në radhë të parë e personave me arsim dhe njohuri të mjaftueshme për çështjet gjuhësore që të bëjnë çfarë të jetë e mundur për ruajtjen dhe kultivimin e sajë. **7**



DOSJA HETIMORE E REVIZIONISTIT MIRASH ZEF PREKA

Komitetit qarkor Shqipëria e lirë dënon pa mëshirë idealet diktatoriale të Enver Hoxhës!

Xhek London te romani i famshëm "Thundra e hekurt" ka venë në gojën heroit të tij romantik shprehjen filozofike. Kur nuk mendoj për të ardhmen, rri e mendoj për atë që nuk është më. Ernest Evarhardi ishte një nga udhëheqësit me të aftë në përgatitjen e lëvizjes punëtore kundër "Thundrës së hekurt" "Në vitet njëzet tridhjetë të shekullit të 20-të Evrahardi kishte një plan madhështorë sa nuk mund të zbatohet nga një njeriu të vetëm. **11**

DUKAGJINI-2012

Libri "Dukagjin 2012", me autor studiuesin e njohur, Luigj Shyti, po sa doli nga shtëpia botuese "Fiorentia", me president gjuhëtarin e përkthyesin Meritan Spahia, një libër me mjaft vlera dhe i domosdoshëm të jetë në bibliotekën familjare, për sot dhe në veçanti për të ardhmen, i domosdoshëm për brezat e ardhshëm.

Luigji, më ngarkojë me një përgjegjësi të madhe dhe të vështirë për të bërë redaktimin dhe pasthënien e këtij studimi, për të cilin e falënderova, dhe bëra një pyetje ta plotësoj këtë detyrë në mënyrë të mundshme të mirë. **5**

Ndoc Mulaj, krenaria e Alpeve Shqiptare dhe inteligjencës nikajmërturase **9**

Shkollimi e edukimi janë çelësi i emancipimit të shoqërisë sonë

“Përparimet tua kënaqësi për prindërit, frymëzim për shoqërinë. Ju jeni e ardhmja e jonë!”, ishte tema e veprimtarisë së radhës që Shoqata Atdhetare “Dukagjini” zhvilloi me datën 13 mars 2022, në mjedisin e shkollës “Edi Durhami”, me qëllimin kryesor, që nëpërmjet këtij takimi, të japim mesazhin apo të tërheqim vëmendjen, se vetëm shkollimi të emancipon e të hap rrugën të ecim përpara në jetë. Gjatë veprimtarisë u vlerësuan 31 nxënës të ekscelencës të klasave të nënta të disa prej shkollave 9-vjeçare të qarkut Shkodër. Në këtë veprimtari përveç nxënësve u vlerësuan edhe 7 mësues për punën e bërë për edukimin e brezave.

Në këtë veprimtari morën pjesë anëtar të Shoqatës, nxënësit e nxënësiet, që u vlerësuan dhe mësuesit kujdestar, prindërit nxënësve, drejtorët e disa shkollave 9-vjeçare, si Gjovalin Kodra, Kujtim Lamthi, Leke Pjetri dhe na nderoj me prezencën e tij, Kryetari i Sindikatave të arsimit të Shkodrës, z. Arjan Peraj, i cili e vlerësoj mjaft këtë nisem, këtë veprimtari të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”.

Veprimtaria ishte planifikuar të mbahej që në vitin 2020, por për shkak të Pandemisë që kaluam gjatë dy viteve të fundit u zhvillua në këtë moment kjo veprimtari dhe u drejtua nga zinjsh. Klodjana Serraj, kryetarja e seksionit për marrëdhënie me publikun të shoqatës.

Fjalën e hapjes së veprimtarisë e mbajti zinjsh. Roza Pjetri, një nga figurat kryesore të shoqatës. Gjatë fjalës spikati përmendja e disa figurave të shquara dukagjinase “Ju drejtohem ju të dashur nxënës, duke ju thënë se ecja juaj sa po ka filluar, do jetë e gjatë dhe lodhshme. Në këtë ecje ju nuk do jeni vetëm, por jeni të shoqëruar nga prindërit, mësuesit dhe shoqëria. Shembulli i të parëve tuaj do ju përcjell dhe do ju bëjë krenarë që jeni pasardhës të Martin Camaj, Kardinal Mikel e Ernest Koliqit, Lin Delisë e Zef Shoshit, Ndrek Lucës, Tinka Kurtit e Pjeter Gjokës, profesor Kole Prella, At’ Luigj Marleka e At’ Benardin Palaj dhe shumë të tjerëve në fushat e ndryshme të jetës”.

Ky është një nga veprimtaritë më të rëndësishme kushtuar arsimit për Dukagjinin, pasi ishte në vijimin e ngritjes së një nga figurat femërore shumë të rëndësishme në edukimin e vajzave dhe grave dhe në këtë drejtim kryesia e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, me vendim nr. 266, date 15 shkurt 2022 vendosi: Të krijohet simboli i nderimit “Mirënjohja mësuese Kushë Micja”, me të cilën do të nderohen mësuesit, nxënësit e studentet dhe ky titull jepet me vendim të veçantë të kryesisë së Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”.

Kush është Kushë Micja?

Për këtë figure kanë studiuar e shkruar plote personalitete të fushës së shkollimit dhe në mes tyre Hamdi Bushati, Simon Rrota, Njazi Kazazi, Gjush Sheldia, Ludovik Shllaku, gazeta e Diaspores e të tjerë e të tjerë dhe të gjithë janë në një mendim, se Kushë Micja ishte e para femër, që hapi shkollën femërore në vitin

1859.

Informacione më të detajuara mbi veprimtarinë e saj në veprimtari u dhanë nga studiuesi, botuesi e publicisti, Kryeredaktori i gazetës “Dukagjini”, zoti Luigj Shyti, që në mes të tjerave theksoi: “Kushë Mica, themeluesja e shkollës së parë për gratë e vajzat shqiptare. Më 16 qershor 1832 në Shkodër, lindi Kushë Mica, themeluesja e shkollës së parë për gratë dhe vajzat shqip-

u mbyll në vitin 1904, 45 vite pas themelimit të saj”.

Shkollat pjesëmarrëse në veprimtari ishin të shumta, prandaj me vendim të veçantë nr. 265, date 15 shkurt 2022, në bashkëpunim me drejtoritë e shkollës 9-vjeçare Bardhaj, “Dede Gjon Luli”-Hot të Ri, “Tring Smajla”-Grude e Re, “Vasil Shanto”-Vrake, “Edith Durhami”, në

Lulashit dhe e Afërditës.

2) Emanuel Rrok Ndou, lindur me 13 tetor 2006, në fshatin Gimaj, i biri i Rrokut e Mirës.

Shkolla 9 vjeçare “Mehmet Shpendi”:

1)Valter Kole Pali, lindur me 17 korrik 2007, në fshatin Lekaj, krahina e Shalës, i biri i Kolës e Tones.

2)Sidorela Gjovalin Sheja, lindur me 7 shtator 2006, në fshatin Abat, krahina e Shalës, e bija e Gjovalinit e Verës

Shkolla 9 vjeçare Theth:

1)Marinela Gjovalin Lokthi, lindur me 4 maj 2007, në fshatin Theth, e bija e Gjovalinit e Manjoles.

2)Kristjana Lulash Vali, lindur me 10 mars 2008, në fshatin Theth, e bija e Lulashit e Tones.

Shkollat 9 vjeçare Pult-Shosh:

1)Sindi Sokol Serraj, datëlindja 10 dhjetor 2006, i biri i Sokol e Mare Serraj, klasa IX, Shkolla 9 vjeçare në fshatin Plan, njësia administrative Pult.

2)Ardita Lazer Brija, datëlindjes 23 shtator 2007, e bija e Lazerit e Tringes, klasa e IX, Shkolla 9 vjeçare në fshatin Khan, njësia adminis-

trative Pult.

3)Klevis Pjeter Çorri, i datëlindjes 21 janar 2007, i biri i Pjeter e Zoje Çorri, shkolla 9 vjeçare në fshatin Palaj, njësia administrative Shosh.

Shkolla 9-vjeçare “Dede Gjon Luli”, në Hot të Ri:

1)Armela Gjergj Kola, lindur me 17 gusht 2008, e bija e Gjergjit e Manjoles, në fshatin Bene, krahina e Shllakut dhe banuese në Hot të Ri . Nxënëse ekscelence në përparim dhe një nxënëse model në paraqitjen e saj në shkollë.

2)Melisa Paulin Mirashi, lindur me 21 korrik 2008, e bija Paulinit e Meritës, lindur në Prekal dhe banuese në Hot të Ri, Presidente e qeverisë së nxënësve e zgjedhur me votat e nxënësve për vitin shkollor 2021-2022, një nxënëse e shkëlqyer në mësim, në interpretim dhe pjesëtarë e grupit të valleve të shkollës.

me motivacion: “Për rezultate të larta në procesin mësimor dhe edukativ; për një angazhim të lartë në përvetësimin e dijeve shkencore dhe në marrjen pjesë aktive në veprimtaritë jashtëshkollore”

Shkolla 9- vjeçare “Vasil Shanto “Vrake:

1)Kristjana Plepi, me origjinë nga Plani dhe me banim në Vrakë, me mesatare 10 dhe me një sjellje shembullore, pjesë e ekipit të futbollit të vajzave, që po përfaqësojnë me shumë dinjitet Malësinë e



tare. Familja e saj, për arsye konflikti gjakmarrjeje, u zhvendosën në Shkodër nga Dukagjini. Filloi të jepte mësim në moshën 27-vjeçar. Një grua e vetëmësuar, për dhjetë vjet studioi me farmacistin Venecian Shjor Marko Rebeskin dhe u thellua në gjuhët frënge dhe italiane. Në vitin 1859, hapi shkollën e parë për gra në Shkodër, të quajtur “Shkolla e Kushë Micës”, ku jepej shkrim, lexim, numra (aritmetike), vizatim, këngë (muzikë) dhe punëdore. Shkolla

lagjen “Mark Lula”, “Martin Camaj”, të njësisë Administrative Shalë, Pult e Shosh, “Zemra e Krishtit” dhe “Dëshmoret e Prishtinës”, për rezultate të shkëlqyera në mësim, u jepet titulli “Mirënjohja mësuese Kushë Micja” nxënësve me rezultate të shkëlqyera secilës shkollë përkatëse, të cilët janë:

Shkolla 9 vjeçare Gimaj:

1)Xhesika Lulash Zelna, lindur me 25 qershor 2006, në fshatin Gimaj, e bija e



Madhe,

2)Majlinda Molla me origjine nga fshati Theth e banuese në Vrake, me notë mesatare 10, me sjellje shembullore,

me motivacion: *“Nxënëse e shkëlqyer në mësim dhe më një sjellje shembullore, e pranishme në të gjitha veprimtaritë sensibilizuese të shkollës”.*

Shkolla 9 vjeçare Bardhaj:

1) Elizabeta Tomë Martini, lindur me 6 korrik 2007 në Shkodër, me origjinë nga fshati Nica, krahinë e Shalës, e bija e Tomes e Bardhës.

2) Gentjana Dedë Shkrepa, lindur me 6 gusht 2007 në Shkodër, me origjine nga fshati Plan, krahinë e Pultit, e bija e Dedës e Valbonës.

me motivacion: *“Për rezultate të larta në procesin mësimor dhe edukativ; për një angazhim të lartë në përvetësimin e dijeve shkencore dhe në marrjen pjesë aktive në veprimtaritë jashtëshkollore*

Shkolla 9-vjeçare “Tring Smajli”, Grude e Re, drejtor Gjesh Doçaj:

1) Vlison Vitor Ndrecaj, lindur me 1 dhjetor 2006, në Shkodër, me origjine nga krahina e Shoshit, i biri i Vitorit e Enkelejdës.

2) Rita Pashk Malaj, lindur me 6 gusht 2007, në Shkodër, me origjinë nga krahina e Shalës, e bija Pashkut e Hënës.

3) Simona Pjerin Shogaj, lindur me 19 qershor 2007, në Shkodër, me origjinë nga fshati Plan, krahina e Pultit, e bija e Pjerinit e Verës.

4) Kristina Mirash Shtani, lindur me 31 dhjetor 2006, në Shkodër, me origjinë nga krahina e Shalës, e bija e Mirashit e Gjulljanës.

5) Landa Pal Çermeli, lindur me 12 tetor 2006, në Shkodër, me origjinë nga krahina e Shalës, e bija e Palit e Lenës.

6) Manuela Tonin Ara, lindur me 28 nëntor 2006, në Shkodër, me origjinë nga krahina e Shoshit, e bija e Toninit e Lizës.

Shkolla 9-vjeçare “Martin Camaj”:

1) Piter Aurel Delija, i biri i Aurelit e Elvanës, me origjinë nga fshati Pecaj, njësi administrative Shalë;

2) Sara Lulash Skollaj, e bija e Lulashit e Nores, me origjine nga fshati Gimaj, njësi administrative Shalë

3) Noel Artur Cukeli, i biri i Arturit e Mimosës, me origjine nga fshati Abat, njësi administrative Shalë.

Shkolla 9-vjeçare “Edith Durhami”, lagja “Mark Lula”-Shkodër:

1) Leonardo Nikoll Zyla, lindur me 20 tetor 2006, në qytetin Shkodër, i biri i Nikolles e Lezes, me origjine fshati Toplane, njësi administrative Temal.

2) Angjelin Kujtim Guri, lindur me 25 maj 2007, në qytetin Shkodër, i biri i Kujtimit e Gjyestes, me origjine nga fshati Theth, njësi administrative Shalë.

3) Frederika Fran Prroj, lindur me 10 shkurt 2007, në qytetin Shkodër, i biri i Franit e Dilores, me origjine nga fshati Gimaj, njësi administrative Shalë.

4) Driot Dede Kodra, lindur me 24 nëntor 2006, në qytetin Shkodër, i biri i Dedës e Luljetës, me origjine nga fshati Gegaj,



njësia administrative Shllak.

5-Desana Fred Ndoci, lindur me 16 nëntor 2006, në qytetin Shkodër, i biri i Fredit e Zines, me origjine nga fshati Mazrek, njësi administrative Shllak.

Shkolla 9-vjeçare “Zemra e Krishtit”:

1) Donato Mark Bobnaj, lindur në Shkodër, me 14 maj 2007, i Markut e Shores, me origjine nga fshati Gimaj, krahina e Shalës,

Shkolla 9 vjeçare “Dëshmorët e Prishtinës”:

1) Reila Pal Pepaj, lindur me 7 tetor 2007, e bija e Palit e Verës, në qytetin Shkodër, me origjinë fshati Kroj i Madh, krahina e Shllakut.

me motivacion: *“Për përparim të lartë në mësim dhe për sjellje shembullore, e pranishme në të gjitha veprimtaritë sensibilizuese të shkollës. Ecnj përpara në shërbim të vetes, familjes dhe Shqipërisë, ashtu si telat e violinës, që të gjithë janë të ndare, por vibrojnë së bashku për të realizuar muzikën e jetës”*

2-Të jepet titulli “Mirënjohja mësuese

kanë punuar me të, me motivacion: *Për përkushtimin dhe arritjet në edukimin e formimin e shumë brezave. Gjithmonë e gatshme për të ofruar kontributin e sajë në shërbim të së mirës ndaj nxënësve dhe kolegeve”.*

2) Kujtim LAMTHI, 26 vite punë, lindur në Theth dhe banues në Vrake. Mësues dhe drejtues i përkushtuar, me motivacion: *“Mësues i përkushtuar dhe drejtues prej shumë viteve ku ka spikatur vazhdimisht me arritjet dhe ka sjellë ndryshimin në institucionet arsimore ku ka punuar”*

Shkolla 9-vjeçare “Edith Durhami”, lagja “Mark Lula”-Shkodër

1-Mimoza Livadhi, drejtoresha e shkollës 9-vjeçare “Edith Durhami” ..., me motivacion: *Për nivel të lartë shkencore e pedagogjike në mësimdhënie shembullor, e cili harmonizon tradicionale me bashkëkohoren, duke sjellë rezultate të larta në procesin mësimor, që ka pasur progres nga viiti në vit. Shumë e përkushtuar për të kultivuar te nxënësit një edukatë shembullore dhe aftësuar për të përballuar sfidat e jetës.*



Kushë Micja”, për mësuesit dhe veprimtarë:

Nga Shkolla 9 vjeçare “Dede Gjon Luli”, në Hot të Ri:

1. Vitore Kodra rreth 30 vite pune në arsim, një mësuese model dhe një kontribuuese kryesore për qepjen e rrobave kombëtare të shkollës.

2. Drita Zefi mbi 35-vite pune në arsim, një mësuese model, drejtuese e grupit artistik të shkollës sonë, kontribuuese për rrobat kombëtare të shkollës dhe e vlerësuar për punën e shkëlqyer në punë, me motivacion: *“Për punën e pazëvendësueshme në edukimin, emancipimin e brezit të ri me parimet më të mira të edukatës qytetare, me dije të plota dhe të trashëgimisë kulturore etnografike të Dukagjinit”.*

Nga shkolla 9 vjeçare “Vasil Shanto”, në Vrake:

1) Age Villi, mësuese e Arsimit Fillor, 38 vite punë, lindur në Vuksanaj, krahina e Shalës dhe banues në Vrake. Mësuese dhe prind i përkushtuar, vlerësim më i lartë nga të gjithë ata që e njohin dhe

Drejtuese e pasionuar e shkollës për rezultate sa më të larta shkencorë në marrjen e dijeve nga nxënësit”

2-Viola Shqau, mësuese, këngëtare dhe e përkushtuar në zbatimin e detyrave, me motivacion: *“Veprimtare e përhershme në punën e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” dhe në kryesinë e saj, si në veprimtaritë kulturore e artistike të shoqatës dhe më gjerë”.*

3- Arjana Funiçi-Martini, mësuese dhe sot inspektore në Drejtorinë Arsimore në Shkodër, me motivacion: *“Për nivel të lartë shkencore e pedagogjike në mësimdhënie shembullor, i cili harmonizon tradicionale me bashkëkohoren, duke sjellë rezultate të larta në procesin mësimor, që ka pasur progres nga viiti në vit. Shumë e përkushtuar për të kultivuar te nxënësit një edukatë shembullore dhe aftësuar për të përballuar sfidat e jetës”*

Fjala mbyllëse në këtë veprimtari u mbajt nga kryetari i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, Ndeu Sanoj, Personalisht mendoj, është një vlerë e

çmuar e gjithçkaje që përcjell për edukimin edhe i tillë duhet të ishte edhe ky fjalim, një nga fjalët frymëzuese për mësuesit ishin *“Ju shpreh mirënjohjen e thelle, për punën tuaj shumë fisnike, që bëni me djemtë e vajzat tona, për t’u dhënë dituri për jetën e tyre, duke pasur me shumë kujdes porosinë e WILLIAM A. ËARD, i cili theksonte: “Mësuesi mediokër flet. Mësuesi i mirë shpjegon. Mësuesi superior demonstroi. Mësuesi i madh frymëzon”, dhe ju frymëzoni nxënësit për të mësuar.*

Gjithashtu gjate fjalës së tij u ndal edhe: *“Sot ishte një dite e veçantë, se kjo dite ishte e nxënësve dukagjinas të shkëlqyer në mësim, të cilët u nderuan nga Kryesia e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, me titullin “Mirënjohja mësuese Kushë Micja”. Në qendër të këtij takimi u shtrua, se shkollimi të emancipon e të hap rrugën e jetës. Të gjithë pjesëmarrësit, nxënësit, mësuesit dhe prindërit e tyre ju shprehim mirënjohjen, që kursyen pak kohe, nga koha e tyre shumë e çmuar, i falënderojmë, që u bënë pjesë e kësaj veprimtarie dhe e gjallëruan atë.*

Kjo veprimtari u përgatiti dhe u zhvillua në saj të mundësisë financiare të dukagjinasve në banim në Kanada: Sokol Sterbyqi, Preke Gjonaj, Mirash Lallinaj, Luigj Lallinaj, Kristian Qershia, Besnik Arrinaj, Nikolle Gerla, Angjelin Rashkadoli dhe Arben Toma, të cilët i falënderojmë dhe ju urojmë: Paçin e dhënçin!

Me këtë rast ju drejto-

hem:

1) Mësuesve, të shkolluarve dukagjinas dhe më gjerë të bëhen pjesë e shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, se do të gjejnë veten dhe jo vetëm kaq, por do të jepni kontributin tuaj shumë të çmuar në emancipimin e bashkësisë sonë aq të nevojshme, së pakut të largohemi nga ndjenja raciste ndër veti, ta pranojmë njeri-tjetrin siç jemi.

2) Biznesmenëve dukagjinas, emigrantëve dukagjinas kudondodhur të bëjnë përpjekje, që nga të ardhurat e tyre, të kursejnë pak, për të mundësuar në realizimin e veprimtarive të shoqatës, se pa këto nuk mund të përgatitet e zhvillohet asnjë veprimtari, të dali as gazeta, me emrin e shtrenjtë “Dukagjini”, e cila me kontributin tuaj ka 220 muaj që del pa ndërprerje dhe në këtë muaj del numri 221, e vetmja gazetë që del në qytetin tonë, Shkodrën”.

Disa opinione:

Këtë veprimtari e ndoqën mediat televizive dhe e pasqyruan në emisionet e tyre:

TV1-Channel, thekson: *“Shoqata at-*

dhetare "Dukagjini", organizoi një veprimtari duke vlerësuar nxënësit ekselent të kësaj zone. Ata theksuan rëndësinë që ka dija, jo vetëm për përgatitjen e të rinjve për të ardhmen, por edhe për nderimin që i bëjnë trevës së Dukagjinit.

TV-Star-Plus, thekson: "Përparimet tua kënaqësi për prindërit, frymëzim për shoqërinë. Ju jeni e ardhmja e jonë" është tema e veprimtarisë, që Shoqata Atdhetare "Dukagjini" zhvilloi sot ku vlerësoi 31 nxënësit e ekselencës të klasave të 9 të disa nga shkollave të qarkut Shkodër të cilët janë me prejardhje nga Dukagjini. Gjatë aktivitetit u vlerësuan edhe 7 mësues për kontributin e dhënë në fushën e arsimit... Veprimtaria u zhvillua në mjediset e shkollës 9 vjeçare "Edith Durham" në Shkodër".

Luigj Shyti, mësuesi, drejtori, studiuesi, botuesi e publicisti, Kryeredaktori i gazetës "Dukagjini", theksoj: "Sot një ditë e veçantë, sot një ditë me plot emocione, sot përpara nxënësve dukagjinës ekselent, dhe mësuesve pararojë kudo që kanë punuar. Faleminderit Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", që mundësoi këtë veprimtari, shumë faleminderit nxënësve që përparojnë me cilësi të lartë dhe na dhanë shumë kënaqësi, të cilët na kthyen emocionalisht në kohën e punës në shkollë. Faleminderit o Kujtim Lamthi si bashkëfshatar dhe dashamirë, si ish nxënës i imi, sot mësues dhe drejtor i suksesshëm. Të uroj suksese të vazhdueshme dhe plot të mira personale dhe familjare".

Donato Bobnaj nxënës i shkollës 9-vjeçare "Zemra e Krishtit": "Është krenari e veçantë që jam bir i Dukagjinit! Vendi i trimave dhe burrave të urte. Studiues dhe shkrimtare nga e gjithë bota kanë evidentuar vlerat e pa përsëritshme të këtij populli. Nga këto troje kanë lindur figura dhe personalitete gjate shekujve që edhe sot i bëjnë nder të gjithë Shqipërisë. Jam mirënjohës i shoqatës atdhetare "Dukagjini", e cila mban gjalle këto tradita me veprimtari të ndryshme, duke publikuar dhe promovuar ato nëpërmes gazetës "Dukagjini", duhet theksuar fakti se kjo gazete vjen në qytetin e Shkodrës pas revistës "Humori Shkodran" botues po nga një dukagjinës, profesor Zef Gjeta, janë pothuajse të vetmet të botuara në vitet e demokracisë në Shkodër. Duke sjelle në vëmendje se Shkodra e artit dhe kulturës në vitet 30' botonte 13 gazeta dhe revista. Veprimtaria e fundit e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", me kryetar Z. Ndue Sanaj organizoi veprimtarinë e përvitshëm kushtuar 7-marsit, duke nderuar nxënësit dhe mësuesit, me mësuesen e pare simbol nga Dukagjini, Kushë Micja. Uroj me gjithë zemër, që këto veprimtari të mos shterojnë asnjëherë, sepse i bëjnë nder jo vetëm Dukagjinit, por gjithë kombit tone! Gjithnjë shfletoj dhe shfrytëzoj rrjetet sociale për të pasur njohuri mbi të parët e mijë dhe duke evidentuar këto vlera, më duket sikur behëm pjese e tyre".

Gjovalin Kodra: Një mirënjohje që prit me lot gëzimi: "Çdo prind dëshiron që fëmija i tij të jetë më i miri. Ambicia më e madhe e një prindi është, që fëmija i tij të ketë suksese në jetë. Fëmijët kanë shumë nevojë për lavdërime dhe për inkurajime.

Lavdërimi sjell me vete forcë, frymëzim dhe motivim për veprime pozitive të mëtejshme. Fëmija e kupton shumë mirë që ka



bërë gjënë e duhur.

Lavdërimi është një gjë delikate, që duhet ditur për ta përdorur në kohën e duhur

Një lavdërim dhe një nderim të veçantë e bëri Shoqata Atdhetare "Dukagjini", me rastin e festës së 7-Marsit, nxënësve të ekselencës dhe disa mësuese nga Dukagjini, ose me origjinë nga Dukagjini.

Atë dita isha i pranishëm edhe unë, sepse nga shkolla jone ishin dy nxënës dhe dy

tij, e cila ishte e shkëlqyer në mësim dhe kur vajza dëgjoj emrin dhe u ngrit për ta marrë titullin e nderit, babai i saj po qëndronte me kokë ulur mbështetur në duart e tij dhe po qante nga gëzimi. Ja çfarë është të nderosh një fëmijë që e meriton dhe kjo meritë është e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", e cila motivoj shumë nxënës dhe mësues.

Ju keni dëgjuar se njerëzit ndahen në tre



mësuese që do të nderoheshin dhe pikërisht nxënëset: Armela Kola dhe Melisa Mirashi dhe mësueset: Drita Zefi dhe Vitore Kodra.

Me bëri përshtypje një gjest i një burri nga Dukagjini, i cili ishte i pranishëm dhe afër meje atë ditë, të cilit nuk po ja përmendi emrin. Ai ishte bashkë me vajzën e

grupe: -audiale-pamje dhe kinestetike, për këtë është e rëndësishme, që njerëzit nga grupi i parë të dëgjojnë, ata të grupit i dytë të shohin dhe grupi i tretë të prekin. Kur lavdëroni fëmijët mos harroni të përdorni jo vetëm fjalë, por edhe përqafim, puthje e buzëqeshje. Fëmija duhet ta shohë gëzimin



dhe krenarinë tënde për të, në sytë e tu të lumtur.

Faleminderit Shoqata Atdhetare "Dukagjini"!"

Piter Delija, nxënës i kl. IX, në shkollën 9-vjeçare "Martin Camaj": "Ishte një njësi fantastike dhe një eufori më përshkoi kur më dhanë titullin e nderit. Më vjen mirë që vijoj të krenoj paraardhësit e mi, sidomos gjyshin tim, Pjeter Delija, që ishte mësues i nderuar për lenden Biokimi".

Noel Cukeli, nxënës i kl. IX, në shkollën 9-vjeçare "Martin Camaj": "Ishte një ndjejnë e paharruar për gjithçka, por mbi të gjitha aty përfaqësova gjyshin tim, Ndue Cukeli, ish një oficer i klasit në kohën e tij. Isha gjithashtu i nderuar kur mu dha titulli i nderit "Mirënjohja mësuese Kushë Micja" nga Shoqata Atdhetare "Dukagjini"

Sara Skollaj, nxënës i kl. IX, në shkollën 9-vjeçare "Martin Camaj": "Ishte një eksperience e re për mua dhe një vlerësim i veçantë. Një motiv për të pasur arritje më të mira, më të larta dhe të vijoj traditën për të nderuar Trevën e origjinës sime. Krenar për gjithë atë trashëgimi, në fushën e atdhetarizmit, të kulturës dhe vlerave njerëzore! Krenar që renditemi në mes atyre emrave të shquar, vijuese e brezit të ri".

Tom Plepi, baba i nxënësës Kristjana Plepit. Ju falënderoj shumë nga zemra për këtë vlerësim të madh që keni bërë për vajzën time, realisht ndihem shumë i lumtur dhe jam krenar që jam nga fshati i Planit. Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" i uroj shumë suksese!"

Kristjana Plepi, jam nxënëse e klasës nënte në shkollën 9-vjeçare "Vasil Shanto"-Vrake, "Ju falënderoj nga zemra ime, për këtë vlerësim dhe nderim të madhe që më ka bërë Shoqata Atdhetare "Dukagjini", duke më nderuar me titullin "Mirënjohjen mësuese Kushë Micja", sot në këtë takim madhështor. Jam shumë e gëzuar dhe e lumtur, njëkohësisht dhe krenare që jam vajzë nga Dukagjini".

Lina Molla, nëna e nxënësës Majlinda Mollës, ju falënderoj shumë për vlerësim që i keni bërë vajzës sime. Ju uroj shumë suksese Shoqatës Atdhetare "Dukagjini"!

Majlinda Molla, jam nxënëse e klasës nënte në shkollën 9-vjeçare "Vasil Shanto"-Vrake, Ju falënderoj shumë për vlerësimin dhe çertifikaten që me keni dhënë sot: "Mirënjohja mesësi Kushë Micja". Ndihej e gëzuar dhe e mbushur me shume emocion. Ju uroj suksese Shoqatës Atdhetare "Dukagjini"!

Reila Pepaj, jam nxënëse e klasës nënte në shkollën 9-vjeçare "Dëshmorët e Prishtinës"- Shkodër: "Ndjehem shumë e vlerësuar, që sot nga Shoqata Atdhetare "Dukagjini", mora vlerësimin "Mirënjohja mësuese Kushe Micja", një nga vlerësimet më të bukur, më nxitës për ecjen në jetën time. Falënderoj këtë shoqate për vlerësimin që u bëri nxënësve ekselent të Trevës sonë! E vlerësoj shumë faktin që Treva e jone akoma kujtohet dhe vlerëson "punëtorët" e vegjël të dijes! Falënderim dhe respekt për ato që punojnë shumë, për të vlerësuar e nxitur brezin e ri në rrugën e dijes."

Redaksia e gazetës "Dukagjini"

DUKAGJINI-2012

Libri "Dukagjin 2012", me autor studiuesin e njohur, Luigj Shyti, po sa doli nga shtëpia botuese "Fiorentia", me president gjuhëtarin e përkthyesin Meritan Spahia. një libër me mjaft vlera dhe i domosdoshëm të jetë në bibliotekën familjare, për sot dhe në veçanti për të ardhmen, i domosdoshëm për brezat e ardhshëm.

Luigji, më ngarkojë me një përgjegjësi të madhe dhe të vështirë për të bërë redaktimin dhe pasthënien e këtij studimi, për të cilin e falënderova, dhe bëra përpjekje ta plotësoj këtë detyrë në mënyrën më të mundshme të mirë.

Para se të mësoni të shkruani, mësoni të mendoni, tërhiqet vëmendja nga personalitete të ndryshme të letrave ... Një qëndrim i drejtë, se nuk është e lehtë të shkruash dhe ketë, që nuk është e lehtë të shkruash, e dinë vetëm ai/ajo që shkruan.

Studiuesi, publicisti e botuesi Luigj Shyti, me këtë botim-studim, si dhe me të tjerat botime-studimi tregojnë se ka e pasur dhe e ka në qendër të vëmendjes gjatë gjithë punës së tij, këtë këshill në të gjitha shkrimet e botimet e tij

Kam lexuar të gjitha studimet e botimet e zotit Luigj Shyti dhe në veçanti, botimet me titull "Gjurmë-syzime etnografike në Dukagjin", "Dukagjini-rrugëtim në gjenezë" dhe "Historiku i arsimit dhe kulturës në Dukagjin", të cilat më kanë venë para përgjegjësisë studimore e arsyetuese mbi ato që jo radhe kanë qenë dhe janë mbi baza shkencore, dhe në veçanti veçoj studimin me titull "Dukagjini, në rrugëtim në gjenezë", i cili ka hedhur bazat e përcaktimit të shtrirjes gjeografike të Dukagjinit të sotëm; largimit nga gojëdhënat mbi Murr Detin, mbi vëllezërit Shalë, Shosh e Mirditë e të tjera e të tjera, që brezat që janë dhe ata që do të vijnë kanë një bazë të shëndoshtë historike e shkencore mbi këtë treve historike.

Studimi, me titull "Dukagjini-2012" pasi e lexova me vëmendje bëra përpjekje ta konceptoj sa më drejte misionin e saj.

Studimin e zotit Luigj Shytit e Zef Lulash Sokolit, "Dukagjini - 2012", mund ta ndajmë në disa tërheqje vëmendjeje:

Së pari: Lëvizjet në përgjithësi të popujve, por në mënyrë të veçantë të kësaj treve.

Me një studim të gjatë në kohë, studiuesi Luigj Shyti dhe Zef Lulash Sokoli përcaktuan në mënyrë shkencore, se popujt apo grup popujsh kanë lëvizur me detyrim apo në mënyrë të lirë, por ama kanë lëvizur. Madje në kohën e pushtimit osman të Shkodrës, kur Pulti i Vogël kishte rreth 32-40 katunde (katundet në përgjithësi ishin mbi bazën e fisit, të një trangu të përbashkët dhe kryesisht merreshin me blegtori dhe ishin edhe të lëvizshëm, nomad), rreth 18 prej këtyre fiseve apo katundeve u larguan dhe jo pak në drejtime të pa ditura, për ne sot.

Lëvizjet e popullsisë së zonës së Dukagjinit ka pasur dhe në kohën e mbretit Zog, por jo me ndonjë qëllim të caktuar nga shteti. Ka pasur lëvizje edhe në kohën e Monizmit, por me pikësnyime të caktuara deri dhe klasore, si në vitet pas çlirimit të vendit, për t'iu dhanë tokë nga reforma agrare e vitit 1946, si në Bregun e Matës, të rrethit Lezhe dhe në Bushnesh, i cili më vonë ka marrë emrin "Dukagjini i Ri", por dhe këto kane qene me kufizime, sa pas vitit 1960 u ndërpre lëvizja e tyre. Po, ka pasur dhe raste, që jo pak individë kane punuar në punë të ndryshme të shtetit dhe një pjese prej tyre kane tërhequr e krijuar dhe familjet, të cilat janë studiuar e vendosur në këtë libër nga Luigji e Zefi.

Së dyti: Një vend të veçantë në këtë studim zë, regjistrimi i popullsisë.

Regjistrimet e popullsisë, aq sa janë

Këto ndryshime, në veçanti janë pas vitit 1967, kur me kushtetute shteti u kthye në vend ateist dhe për rrjedhojë nuk lejoheshin emrat fetar.

Ndryshime të emrave, kemi pasur pas vitit 1990, me kalimin në sistemin demokratik dhe lëvizja e popullatës po bëhej e lirë, me kalimin në vendet e Evropës deri në Amerikë e Australi, po të thuash emrat e fëmijëve kane ndryshuar plotësisht, me gjithë përpjekjet për ti vendosur ato me prejardhje ilire.

Së katërti: Një objekt tjetër me rëndësi është përcaktimi i vendosjes së mbiemrave, që jo pak, pas vitit 1990 janë paragykuar. Në Dukagjini, po të thuash asnjë fis apo familje nuk kishte mbiemër, se secili nuk shkonte me mbiemrin më larg në brezni, se deri te gjyshi. Prandaj mbas çlirimit të vendit, pas viteve 1946 u ngritën komisio-

kishin e kane një mbiemër.

Së pesti: Një objekt tjetër mjaft i rëndësishëm, madje nga më të rëndësishmit, është lëvizja e popullatës, pas vitit 1990, me një përcaktim të qartë, në baze krahine e fshati. Ky studim është i rëndësishëm, se mbahet e gjalle lidhja me prejardhjen e atyre që janë largua kryesisht jashtë atdheut. Madje, është mjaft e rëndësishme shembulli i disave prej tyre, që janë larguar në kohën e Monizmit kanë marrë për mbiemër, emrin e fshatit apo krahinës së lindjes, me qëllim që të mos harrohet prejardhja. Kjo ndodhe dhe në kohën e sotme, por pak më radhe.

Në mbyllje të këtyre mendimeve e vlerësosh shumë këtë studim, i cili me kalimin e kohës, nga brezat e rinj do t'ri rriten vlerat aq sa e bënë të domosdoshëm të jete



bërë dhe që janë bërë edhe më vonë, janë bërë nga pushtuesit me qëllime për të mbledhur taksat. Ato, për here të pare u bënë në vitin 1416-1417, siç theksohet "Regjistri i kadastrës dhe i koncesioneve për rrethin e Shkodrës", nga republika e Venedikut. Pastaj janë regjistrimet e vitit 1485, osman e kështu me radhe deri në vitin 2007, që tregon dinamikën e lëvizjes së popullsisë, që me aq përgjegjësi janë studiuar e pasqyruar me pasqyra të veçanta nga zoti Luigj e Zef.

Së treti: Një objekt me rëndësi të veçantë paraqitet në këtë libër nga studiuesi Luigj Shyti e Zef Sokoli, emrat e njerëzve, për meshkuj e për femra, të cilat janë fetare dhe radhe here pagane, por që me vijimin e kohës, me lëvizjen e popullatës emrat janë vendosur dhe më modern.

ne për vendosjen e mbiemrave. Ashtu siç e përcakton dhe studiuesi edhe në analizën time nuk pati ndonjë rregullsi mbi tringun e fisit, por mbiemrat u vendosen mbi bazën e dëshirave apo me imponim mbi bazën e pemëve apo të objekteve të ndryshme të tokës. Këto mbiemra janë vendosur në këtë mënyrë nga mungesa e përgjegjësisë së kryetareve të familjeve dhe anëtareve të komisionit vendas. Kështu, kryesisht ka ndodhur në trevën tonë dhe jo në trevat e tjera. Siç e ka shkruar dhe Luigji e Zefi. Vetëm në familjen time, me trung të përbashkët Sani dhe që janë 5 breza, janë vendosur tre mbiemra (Sanaj, Kola e Çardaku). Vendosja e mbiemrave ishte një domosdoshmëri, ashtu si në Jug, që pavarësisht nga qëndrimet politike në mes familjeve apo anëtareve të fisit, ata

në bibliotekën e çdo familjeje, se vetëm në këtë mënyrë nuk mund të harrohen nga brezat e ardhshëm prejardhja e tyre. Brezit të sotëm ju del një detyrë tepër atdhetare, që fëmijëve të tyre t'iu lenë të shkruar origjinën e tyre, qoftë dhe me dorëshkrim, në një fletore të veçantë.

Ju lumtë studiuesi, botuesi e publicisti Luigj Shyti, dhe dëshirëmadhit Zef Lulash Sokolit, ju përgëzoj për përgjegjësinë që keni marrë përsipër dhe për punën që keni bërë.

Ndue Sanaj,
Shkodër, më 15 mars 2022

DITËT QË BASHKOJNË MIQTË

Çaste të paharruara nga Jubileu i dhjetë i “Ditës së Miqësisë së Gazetarëve”

S'ka si të ndodhë më bukur se kaq, kur gjendesh mes gazetarësh profesionistë për dy ditë radhazi, mbështjellë me petkun e ngrohtësisë së miqësisë së ndërsjellët të kolegëve. Do ta quaja jo vetëm një takim pune frytdhënëse, ku secili prej nesh shkëmben eksperiencën e tij, por edhe një takim vëllazëror mes kolegësh nga Shqipëria e Kosova, me të cilët miqësia merr kuptim akoma më shumë, sepse ka një mision të përbashkët e të shenjtë: qenien gardiane e përcues të fjalës së lirë dhe të medias së pavarur.

Në “Ditët e Miqësisë”, organizuar në Republikën e Kosovës, ishin të përfshira brenda harkut kohor dy ditore, një mori veprimtarish të mirëorganizuar nga Unioni i Gazetarëve të Shqipërisë, të inicuar nga Unioni i Degës së Elbasanit dhe “Ress Egnatia” përfshirë këtu edhe Unionin e Gazetarëve të Kosovës. Të gjitha këto veprimtari, sipas programit, ishin të përqendruara në qytetet e Prishtinës, të Mitrovicës dhe në Prekazit si destinacionet kryesore të udhëtimit, akomodimit dhe vizitave tona më të rëndësishme.

Kjo ngjarje e rëndësishme i UGSH-së ka qarkulluar këto 10 vjet në shumë qarqe të vendit dhe rajonit. Nga Saranda deri në Shkodër, Shkup, Preshevë e Bujanoc ku UGSH-ja ka përcjellë mesazhet e tij të miqësisë dhe të bashkëpunimit mes bashkësive të gazetarëve, i cili si destinacion të jubileut të 10-të kishte zgjedhur të mbahet në Prishtinë dhe Mitrovicë.

Iniciatorë kryesorë kreu i UGSH-së dega Elbasan, Besim Dybeli, Shoqata “Ress Egnatia” e drejtuar nga Xhimi Vila dhe kryetari i Unionit të Gazetarëve Shqiptarë Aleksandër Çipa, u vlerësuan si “truri dhe vula” e kësaj veprimtarie të rëndësishme të UGSH në këtë jubile të 10-të të miqësisë dhe bashkëpunimit. Duke dashur që “Dita e Miqësisë” të prekte çdo cep territorial të trungut etnik, organizatorët janë kujdesur vit pas viti që përgjatë gjithë kësaj dekade, kjo veprimtari të zhvendosej në qytetet më të rëndësishme të Shqipërisë, të Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut, në Shkup, në Preshevë e Bujanoc ku vitin e kaluar u mblodhën së bashku më shumë se 100 gazetarë shqiptarë. Ndërsa këtë vit në përvjetorin e 14-të Pavarësisë së Kosovës kjo veprimtari u zhvillua në Prishtinë e Mitrovicë me pikësynimin tematik pasqyrimin e realitetit aktual të këtij shteti në marrëdhënie me “Ditën e Miqësisë”.

Ndërkaq, falë kontributit dhe këmbënguljes së kryetarit të UGSH-së Aleksandër Çipa, kryetarit të UGSH-së në Elbasan Besim Dybelit si dhe Xhim Vilës, kryetar i Shoqatës “Ress Egnatia”, pjesë e kësaj ngjarje u bënë edhe gazetarët nga Lugina e Preshevës. Kontribut të veçantë solli edhe gazetari Valon Gashi, kryetar UGLP-së, i cili arriti të ndërtojë urën lidhëse mes Luginës dhe Shqipërisë në bashkëpunim

me Nexhat Behlulin, presidentin e kompanisë mediale “Spektri”.

Ndër veprimtaritë kryesore gjatë kohës

të reportazhistit kulturor dhe mikut të gazetarëve ndërkombëtarë në mediat kulturologjike. Botime të shumta në formate

të investojë në krijimin e profilit të gazetarit profesionist, të besueshëm dhe solidar. Kontributi për gazetari cilësorë dhe aktivizimi i tij në rrjetin e reporterëve ndërkombëtarë, janë përfaqësim dinjitoz i gazetarit shqiptar në tërësi.

Mrekullia e kësaj veprimtarie ishte edhe prezantimi i përkryer nga gazetarja dhe moderatorja simpatike Alketa Gashi Fazliu, që me aftësitë e saj brilante, me buzqeshjen e saj të bukur dhe të sinqertë, me finesën e saj, me profesionalizmin dhe improvizimet që ajo krijoi në mënyrën më të përkryer, i dha larmi kësaj veprimtarie, duke na dhuruar kënaqësi dhe emocione të jashtëzakonshme.

Të nesërmen u organizua një takim në Mitrovicë në ambientet e radio-televizionit të drejtuar nga Nexhmedin Spahiu, ku morëm një sërë informatash para luftës, gjatë luftës dhe pas luftës, për ndarjen e Mitrovicës në Veri e Jug e të tjera.

Më pas vijua me vizitën në Prekaz në Kullën e familjes heroike Jashari.

Ajo që i dha më shumë kuptim miqësisë sonë ishte dreka bujare e vëllazërore e shtruar nga drejtori i televizionit të Mi-



dy ditore spikatën: -Pritja nga autoritete zyrtare të Republikës së Kosovës. -Përurimi i librit “Hotel Bejruti”, botim i UGSH të gazetarit të mirënjohur dhe reporterit të luftës Nehat Islami. -Tryeza me temë

dhe zhanre të ndryshme të gazetarisë kulturore, e evidentojnë Sejmen Gjokolin si një ndër më aktivët e kësaj fushe në krejt hapësirën shqiptare.

Gjithashtu, në këtë shkrim dua të veçoj



“Skenat mediatike në kërkim të një tregu mediatik”. -Ndarja e çmimeve nga organizatorët, ku mund të veçoj Sejmen Gjokolin nga Vlora, i cili prej disa dekadash është një veprimtar i shquar i kulturës kombëtare, duke krijuar modelin e veçantë

edhe z. Bahri Cani, reporter dhe moderator i njohur i radiotelevizionit dhe për një periudhë shumëvjeçare gazetar i Deutsche Welle në shqip. Me punën dhe raportimin e vet shumëvjeçar ka ndikuar mbi audiencat shqipfolëse dhe ia ka dalë

trovicës z. Nexhmedin Spahiu, një drekë në nderim të miqve e përcjellë me atmosferë, muzikë dhe diskutime, të cilat farkëtuuan me shumë dinjitet miqësinë tonë të ndërsjellë. Lidhur me këto ditë të veçanta të Miqësisë, gjej rastin të falënderoj kryetarin e Unionit të Gazetarëve dega Shkodër z. Gaspër Marku, për mundësinë dhe veçantinë që i dha pjesëmarrjes time në këtë veprimtari mbarë kombëtar. Po kështu i shpreh mirënjohje tejet të sinqerta kryetarit të UGSH z. Aleksandër Çipa, për organizimin e këtyre veprimtarive të jashtëzakonshme, të cilët na lidhën në miqësi reciproke me kolegët tanë nga të gjitha trojet tona etnike. Suksese të gjithë gazetarëve shqiptarë kudo ku e zhvillojnë veprimtarinë e tyre dhe mirë u takofshim në të tjera aktivitete të tilla frytdhënëse.

Nga Ramazan Çeka



PROBLEME TË GJUHËS SHQIPE

Gjuha shqipe ka kaluar një etapë të gjatë të zhvillimit të sajë. Ajo sot është shumë e rrezikuar nga përdorimi i panevojshëm i fjalëve nga gjuhët e huaja edhe kur ato i kanë të barabartat e tyre në gjuhën shqipe. Problemin e përdorimit të fjalëve nga gjuhët e huaja në të folurën shqipe e kanë ngritur qysh në shekullin e XVII Pjetër Bogdani dhe kontribuuesit e tjerë të ruajtjes së sajë.

Gjatë shekujve të parët tanë e ruajtjen gjuhën e tyre pavarësisht se ajo formën e plotë të sajë e mori në Kongresin e Manastirit në vitin 1908. Sot asaj i kanoset një rrezik i dyfishtë, asimilimi nga përdorimi i panevojshëm i fjalëve të huaja dhe përdorimi pa kriter i dialekteve të ndryshme në punimet e shkruara dhe të publikuara.

Nisur nga këto fakte, është detyrë e të gjithë popullit shqiptar, por në radhë të parë e personave me arsim dhe njohuri të mjaftueshme për çështjet gjuhësore që të bëjnë çfarë të jetë e mundur për ruajtjen dhe kultivimin e sajë.

Kjo detyrë nuk është një problem vetëm gjuhësor dhe shkencor, por edhe një problem shumë i madh kombëtar.

Fjalë çelës

Gjuha, kongresi, komisia letrare, fjalë të huaja, dialekte, gjuhë normative, akademi, institut.

HYRJE

Të nderuar lexues,

Kongresi i Manastirit ka qenë ngjarje madhore në historinë e kombit tonë jo vetëm se aty u morën vendime me rëndësi për gjuhën shqipe, por edhe për arritjen e një dakordësie midis përfaqësuesve të krahinave dhe të subjekteve fetare pjesëmarrëse në Kongres. Mbas një pushtimi rreth 500 vjeçar nga një regjim që mohoi kombin dhe gjuhën shqipe në vijimësi, duke e ndarë Shqipërinë në 4 vilajete dhe duke mos lejuar me ligj, shkrimin e gjuhës së folur nga shqiptarët, ishte i rrezikuar vetë qenia jonë si komb dhe si shtet më vete në kohën e fundit të Perandorisë Osmane. Koha tregoi se shumë shqiptar ishin të indoktrinuar plotësisht nga ideologjia e pushtuesit, nga feja dhe zakonet e tij, dhe dolën haptazi, deri edhe me armë, kundër pavarësisë së Shqipërisë nga Turqia dhe flamurit të saj kombëtar. Këta renegat të fesë dhe kombit të tyre, nuk gjetën mbështetje as në shtresat e gjera të popullit, as në shtresën e intelektualëve të kohës, nëpunës të Perandorisë ose emigrantë në vendet mike të kombit tonë.

Prandaj edhe duhet nderuar dhe kujtuar vepra atdhetare e atyre burrave, që në qytetin e Manastirit hodhën themel e gjuhës së shkruar shqipe, duke u ndarë njëherë e përgjithmonë nga Perandoria Osmane, perandori e shtypjes dhe skllavërimit të popujve.

A DUHET TË MBAHET NJË KONGRES I DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE

Kapitulli I

1.1 Kur ka filluar të shkruhet gjuha shqipe?

Studiuesit e gjuhës shqipe kanë shprehur mendimin se ajo është shkruar qysh në vitet e para të shekullit XIII dhe ndoshta

edhe më herët. Në botimet e mëparshme është thënë se “shqiptarët kanë një gjuhë të tyre, por ajo shkruhet me germa latine”. Në Regjistrin e Kadastrës dhe të Koncesioneve për Rrethin e Shkodrës të vitit 1416-1417 janë shkruar një numër i madh fjalësh në gjuhën shqipe me germa latine, kryesisht emra vendesh dhe vendbanimesh. Është plotësisht e mundur dhe e besueshme që edhe më përpara të jetë



shkruar gjuha shqipe në forma të ndryshme, me alfabetë që përdorshin në atë kohë në Evropë.

Deri sot janë të njohura shkrime në gjuhën shqipe nga Pal Engjëlli me formulën e pagëzimit, në vitin 1462; “Fjalorthi i fon Harfit” i vitit 1496; Meshari i Gjon Buzukut i vitit 1555; Lek Matrënga në vitin 1592. Pastaj vijnë me radhë poezi nga Pal Hasi para vitit 1612; Pjetër Budi rreth vitit 1612; Frang Bardhi me fjalorin Latinisht Shqip të vitit 1635; Ndre Bogdani para vitit 1675 me një gramatikë të shqipes; Pjetër Bogdani me librin “Çeta e Profetëve”, që konsiderohet libri i parë në prozë në gjuhën shqipe; Françesko Maria da Leçe me gramatikën e gjuhës shqipe, me 274 faqe në vitin 1716; Don Pal Zogaj me një gramatikë të shqipes në vitin 1769. Në shekullin XIX u botuan gramatikat e K. Kristoforidhit më 1882; S. Frashrit më 1886; J. De Radës më 1894, i cili kishte botuar një gramatikë edhe më parë, më 1871. Një vonesë kaq e madhe kodifikimit dhe shkrimit të gjuhës shqipe ka ardhur nga shumë faktor, por shkaku kryesor ka qenë pushtimi turk i vendit tonë dhe censura e pushtuesit për shkrimin e sajë. Para Kongresit të Manastirit, gramatika e fundit e gjuhës shqipe ka qenë ajo e Gaspër Jakova Mërturit e shkruar në vitin 1904.

1.2 Kur janë hapur shkollat e para shqipe?

Deri sot pranohet se shkollat e para shqipe kanë filluar të hapen nga klerikët e fesë katolike në shekullin XVI. Në vitin 1367, në Kishën e Shën Palit në territorin e sotëm të Pukës, ka qenë e hapur një shkollë në nivelin e sotëm të shkollës së mesme. Sot, nga shumë studiues, besohet dhe pranohet që shkolla e parë shqipe u hap në Stubëll të Malit të Zi të Karadakut në vitin 1584. Më vonë janë hapur shkolla në

hjetë tekste abetaresh si më poshtë:

1. Naum Veqilharxhi, “Fare i shkurtër e i përdorçim Ëvetar shqip” (1844, 1845)
 2. Panajot Kupitori, “Abetare e gjuhës shqipe” (1860)
 3. Anastas Byku, “Gramme për shqiptarë” (1861)
 4. Konstandin Kristoforidhi, “Abetare skip” (1867, 1869, 1872)
 5. Daut Boriçi, “Abetare shqip” (1869)
 6. Vasil Dhimitër Ruso, “Pellazgjika shqip alfavitare”, Bukuresht 1877
 7. Jani Vreto, “Alfabetare e gjuhës shqip”, Kostandinopojë 1879
 8. Anastas Kullurioti, “Abavetar” (1882)
 9. Sami H. Frashri, “Abetare e gjuhës shqip”, (1886, 1888, 1900)
 10. Jovan Risto Tërova: “Abetarea shqipe”, Bukuresht 1887
 11. Gaspër Benusi, “Abetare e gjuhës shqyp”, Bukuresht 1886, 1890
 12. “Abetari i qitun pri shoqni t’ Bashkimit t’ gjuhës shqype”, Shkodër 1899
 13. Said Najdeni, “Abetare e gjuhës shqipe”, Sofje 1900
 14. Shtjefën Gjeçovi, “Abetarja e Zymit” (1900)
 15. Ndre Mjeda, “Këndime për shkollë të para”, Vjenë 1904
 16. Luigj Gurakuqi, “Abetari për mësoitore filltare t’ Shqypnis”, Napoli 1905, Bukuresht 1906
 17. “Abetare toskërisht, pas abecesë së vjetër të Stambollit”, Sofje 1908
 18. “Abetare gegërisht, pas abecesë së vjetër të Stambollit”, Sofje 1908
- Ndoshta ka edhe të tjera abetare që mund të jenë shkruar në këtë periudhë, por edhe 18 abetare në 60 vjet nuk janë pak për një vend të vogël si ky yni.

1.4 Alfabeti i përdorur para Kongresit të Manastirit

Në të gjitha botimet para vitit 1908, ka qenë problem shkrimi i gjuhës shqipe mbasi nuk kishte një alfabet të miratuar. Në shkrimet e tyre shkruhet e shqipes kanë vënë në fillim një lloj alfabeti dhe mënyrën e leximit të shkrimit. Pothuajse gjithmonë, me përjashtim të ndonjë rasti kur shkrimi i shqipes është bërë me germa greke, baza e shkrimit të shqipes ka qenë alfabeti i gjuhës latine. Për të shkruar gjuhën latine kanë mjaftuar 30 germa. Për të shkruar gjuhën shqipe, e cila ka një numër të madh fonemash, sot përdoren 36 germa, por në realitet, shumë tinguj të kësaj gjuhe, të cilët përdoren në të folurën e përditshme nuk arrihet të shkruhen, por ato zëvendësohen me germa standarde. Edhe Buzuku, edhe Bardhi, edhe Bogdani, edhe të tjerët mbas tyre, kur kanë shkruar kanë përdorur tërësisht alfabetin latin, duke shtuar edhe disa shenja të tjera të huazuara nga gjuhët greke dhe sllave, ose duke shpikur vetë simbole të tjera për shkrimin e shqipes. Rast tipik i këtij veprimi ka qenë prifti katolik i rritit grek, Nilo Katalano, i cili në vitin 1675, hartoi një alfabet të tijin me 54 germa dhe një gramatikë të shqipes. Me këto dy arritje ai hapi shkollën shqipe në Himarë me njëqind nxënës. Ky ka qenë një kontribut shumë i madh i tij, por pak është punuar

gjuhën shqipe në Janjevë, Kurbin, Pllanë, Himarë, Rrjoll dhe Shkodër, të gjitha para vitit 1700. Mbas vitit 1700 kanë vazhduar shkolla në gjuhën shqipe në të gjithë territorin e Arbërisë së asaj kohe, në Janjevë, Varazhdin, Shkodër dhe shumë vende të tjera. Mbas vitit 1800 shkrimi i gjuhës shqipe ka marrë hov të madh në Trevat shqiptare të pushtuara nga turqit dhe në diasporën shqiptare në Jug të Italisë nga studiuesit arbëresh. Këtë shërbim atdheut tonë ja kanë kryer në masën pothuaj qind për qind klerikët shqiptarë në të dy anët e detit Adriatik. Në gjuhën shqipe këta kontribuues janë quajtur patriotë dhe atdhetar të mëdhenj, sepse vepra e tyre ka qenë në fushën e kultivimit të gjuhës shqipe.

1.3 Kur u shkruan abetaret e para?

Me rritjen e kërkesave për shkrimet shqipe, me përgatitjen e gramatikave, me përkthimet kishtare nga gjuhët greke, italiane dhe latine, me shtimin e numrit të shkollave dhe me nxitjen dhe mundësimet financiare e Perandorisë së Habsburagse. Pra, Austrohungarisë, hartimi i abetareve për shkolla u bë kërkesë e kohës në mesin e shekullit XVIII. Patriotët që kishin qëllim shkruarjen e gjuhës, por në radhë të parë çlirimin e vendit nga pushtuesi turk, ju vunë punës në mënyrë të ethshme për hartimin e abetareve. Në harkun kohor të gjashtëdhjetë viteve u shkruan tetëmbëd-

nga studiuesit për hulumtimin dhe publikimin e veprës së Katalanos.

Në arkivin e Grotaferratës dhe në Arkivin e Propagandës Fide në Vatikan, kam parë një numër jo të vogël të dokumenteve të asaj kohe, shumica të pa publikuara deri sot. Kjo është një punë që në të ardhmen besoj se do ta kryejnë studiuesit e rinj të gjuhës dhe të historisë dhe nuk është objekti kryesor i këtij shkrimi.

1.5 Ku flitej gjuha shqipe?

Është e vështirë të përcaktohej me saktësi se deri ku shtrihet e folura në gjuhën shqipe dhe në cilin dialekt flitej.

Dëshminë e parë të shkruar për zonat shqipfolëse e kemi nga libri i Françesko Marias da Leçe të vitit 1716. Ai në hyrje të librit të tij ka shkruar: "Fati më caktoi Shqipërinë dhe shkova aty me bindje të verbër. Por, ç' mund të bëja unë në ato anë pa ditur gjuhën aq të vështirë të atij vendi? Ç'të mirë mund të shpresonte prej meje Feja jonë? A do mund të prisnin Shkëlqesitë Tuaja ndonjë lajm të mirë prej meje lidhur me kthimin e banorëve të atyre anëve në fenë tonë? Dhe në fund, ç' rezultat do arrija unë vetë, përveçse do provoja mbi lëkurën time mësimin që vjen nga ai proverb i vjetër: "Askush s'ta vë veshin kur i flet në gjuhë të huaj". Ndaj ju vura me shumë zell punës për mësimin e asaj gjuhe dhe me shumë mund ia dola mbanë. Me habi konstatova se kjo gjuhë flitet në gjithë shtrirjen e Mbretërisë së Epirit, në një pjesë të Rumelisë e të Mbretërisë së Serbisë, në vende të veçanta të Bullgarisë, në Stamboll, në Dalmaci, thuajse në të gjitha provincat e Mbretërisë së Napolit dhe në ndonjë krahinë të Sicilisë." P. Francesco Maria da Lecce, "Osservazioni grammaticali nella lingua Albanese", Roma, 1716, p.2-3

Gjatë hulumtimit të shkrimeve të vjetra të gjuhës shqipe, krahas studimeve që kanë kryer studiuesit e tjerë, kam zbuluar që në gjuhë shqipe ka shkruar prifti francez fra Giacinto nga Sospello në një libër me 510 faqe në dorëshkrim, i pabotuar deri më sot, në të cilin ai ka përdorur i pari fjalën shqiptar në një dokument të shkruar të njohur deri më sot, dokument të cilin e kam publikuar para muajit tetor 2021 në disa gazeta dhe televizione. Kam publikuar në Revistën "Hylli i Dritës" fletë nga regjistri i kishës së famullisë së Shalës, të shkruara në gjuhën shqipe në vitin 1778. Kam publikuar edhe dy dokumente të shkruara në gjuhën shqipe, në kishën e Nikajve para vitit 1883.

Në kushtet kur shqiptarët jetonin si pjesë e Perandorisë Osmane, ka pasur lëvizje shumë të mëdha të popullsisë të krahinave shqiptare në tërë Perandorinë Osmane, por edhe jashtë sajë. Kjo ka bërë që të krijohen bashkësi shqipfolëse në shumë vende siç shkruhet më sipër. Në shtetin e sotëm turk ka një bashkësi shqiptarësh rreth 5 milion, por ata po asimilohen dhe po konvertohen në turq në mungesë të shkollave shqipe dhe të kultivimit të gjuhës së tyre. Shqiptarë ka me shumicë edhe në Liban, Egjipt, Ukrainë, Argjentinë, SHBA dhe shumë vende të tjera, por ata po e humbasin gjuhën dhe kombësinë e tyre.

Kapitulli II

2.1 Kongresi i Manastirit

Përmbysja e regjimit despotik dhe ardhja në fuqi e Xhonturqve ose turqve të

rinj në Perandorinë Osmane, u duk sikur i dha një frymë evropiane edhe qeverisë së asaj perandorie. Shqiptarët nxituan menjëherë të nxjerrin përfitimet e tyre në situatën e krijuar.

Intelektualët shqiptarë, atdhetarë të vërtetë, të të gjitha besimeve fetare, ranë dakord të mbanin një Konferencë Akademike mbi gjuhën shqipe në Manastir, kryeqendra e vilajetit me të njëjtin emër.

Kjo Konferencë ka hyrë në histori me emrin Kongresi i Manastirit dhe u mbajt mes datave 14 deri 22 nëntor 1908, për standardizimin e alfabetit të gjuhës shqipe. Qëndrimi i delegatëve ndaj punimeve të këtij Kongresi ka qenë shumë fisnik dhe unifikimi i alfabetit të shqipes ka qenë një arritje e madhe kombëtare. Vendimet e këtij kongresi konsiderohen guri i themelit i gjuhës normative të kombit shqiptar.

Është e dhimbshme që njëri nga kontributorët më të mëdhenj të shkrimit të shqipes nëpërmjet gazetës "Albania", që botohej në Bruksel, Faik Konica, u shpreh kundër këtij kongresi.

Më gjithë ndonjë kundërshtie, që nuk pati ndonjë impakt për pengimin e vijueshmërisë së shkrimit shqip, kongresi gjeti miratim në të gjitha trevat ku flitej gjuha shqipe.

Ky kongres është i ruajtur në Arkivin Qendror të Shtetit i filmuar megjithëse pa zë. Materialet e kongresit janë të ruajtura dhe të publikuara shumë herë gjatë këtyre 110 viteve. Nuk është qëllimi i këtij shkrimi as publikimi as analiza e këtij kongresi, sepse studiues të tjerë kanë bërë mjaft publikime me vlera lidhur me punimet e tij.

2.2 Vijimësia e punës për unifikimin e gjuhës dhe të shkrimit

Mbas këtij kongresi, vazhdoi një punë e ethshme për publikimin e veprave në gjuhë shqipe dhe për unifikimin e shkrimit. Barrën kryesore e mbajti shtypshkronja françeskane në Shkodër e drejtuar nga Dom Ndoc Nikaj. Në këtë shtypshkronjë u shtypën mijëra shkrime, libra, revista dhe broshura. Krahas punimeve të tjera, punime me rëndësi në atë kohë kanë qenë punimet e Shtjefën Gjeçovit për Kanunin e Lek Dukagjinit, të Gjergj Fishtës për Lahutën e Malsisë, botimi i revistës prestigjioze "Hylli i Dritës" dhe i disa revistave të tjera. Krahas këtyre botimeve, ka vijuar puna intensive nga diaspora shqiptare me botime në qendrat e sajë, Bukuresht, Egjipt, Boston, Kalabri dhe vende të tjera ku janë shtypur shumë punime në gjuhën shqipe, duke dhënë një kontribut shumë të madh për unifikimin e gjuhës. Është me vend të shënojmë këtu, që në shtypshkronjën françeskane në Shkodër, pothuaj gjatë gjithë kohës u shkrua shqip, por në dialektin gegë të kësaj gjuhe. Me kalimin e viteve, u shtuan numri i shtypshkronjave dhe i botimeve në gjuhë shqipe, por pa një direktivë të përcaktuar mirë për unifikimin e sajë.

Kontribut me vlera ka qenë krijimi i Komisionit Letrar në vitin 1916 në Shkodër, me 1 shtator 1916 dhe Kongresi Arsimor i Lushnjës me 1920.

Komisia Letrare është institucioni i parë që hartoi "Rregulla mbi ortografinë e gjuhës shqipe", duke dhënë kodifikimin e parë të drejtshkrimit tonë, në të cilën u vendos që gjuha standarde shqipe të jetë

gjuha letrare e normëzuar mbi dialektin e Elbasanit. Ky vendim u sanksionua edhe me botimin në "Fletoren zyrtare" të Shqipërisë më 1923, mbasi kishte marrë edhe miratimin në Kongresin Arsimor të Lushnjës më 1920. Në këtë Kongres ishte njësuar edhe terminologjia që do të përdorej në tekstet shkollore. Tani edhe studimi i strukturës gramatikore të gjuhës shqipe bëhej, kryesisht, mbi këtë bazë. Mund të thuhet se shumica e gramatikave që u botuan në periudhën e Pavarësisë ishin në mbështetje të plotë të vendimeve të Komisionit Letrar Shqipe të Shkodrës.

Në vijim të punës shkencore për unifikimin e gjuhës përpjekje për të organizuar veprimtarinë shkencore u bënë më 1940, me krijimin e Institutit të Studimeve Shqiptare, në të cilin, në kushtet e pushtimit italian, u përfshinë studiues të njohur shqiptarë dhe italianë, të gjuhës, letërsisë dhe të artit. Kryetar i parë i këtij Instituti ishte Ernest Koliqi dhe sekretar i përgjithshëm Zef Valentini, ndërsa ndër anëtarët kishte intelektualë të shquar si Aleksandër Xhuvani, Ekrem Vlora, Eqrem Çabej, Karl Gurakuqi, Kole Kamsi, Lasgush Poradeci, Lazër Shantoja, Sotir Kolea, Vangjel Koça e të tjerë. Më 1942 u quajt Instituti Mbretënor Shqiptar, në varësi të Kryeministrit. Në periudhën e pushtimit gjerman (1944) Instituti u riorganizua dhe u quajt Instituti për Studime e Arte, me zgjerimin e fushave të kërkimit e të numrit të studiuesve, tanimë vetëm shqiptarë, të ndarë në tri degë: gjuhësi, arte dhe shkencë natyrore e teknike. Në këtë institucion u përfshinë edhe intelektualë të tjerë të njohur të kohës, si: Ali Asllani, Arshi Pipa, Hamdi Sulçebe, Hasan Dosti, Krist Maloki, Kristo Floqi, Ndoc Nikaj, Mithat Frashri, Odhise Paskali, Spiro Konda, Vasfi Samimi, Vedat Kokona e të tjerë.

Mbas vitit 1944, ngjarja kulmore për unifikimin e gjuhës së shkruar në të gjitha trevat ku flitej shqip, brenda dhe jashtë kufijve shtetëror, ka qenë Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe.

Ky Kongres u mbajt nga data 20 deri më 25 nëntor 1972, në Tiranë me nismën e Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë dhe me praninë e 87 delegatëve nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe arbëreshët e Italisë. Ky kongresi, pa asnjë dyshim ka qenë ngjarja më e rëndësishme e shekullit XX për gjuhën tonë kombëtare pas Kongresit të Manastirit që miratoi alfabetin.

Mbas shumë debatesh, nisur kryesisht nga motive atdhetare, për të ruajtur unitetin kombëtar, Specialistët e gjuhës, miratuan rregulla, që ishin të ndikuara edhe nga politika e kohës, duke qenë në kundërshtim të plotë me bindjet shkencore të shumë prej tyre, akademikë dhe njohës shumë të mirë të problemeve gjuhësore.

Mbas vitit 1990, kur këta specialistë mund ta thoshin mendimin e tyre të pandikuar dhe të pa frikësuar nga politika, filluan të dalin në shtyp kritikën e para për vendimet e këtij Kongresi. Edhe këto kritika nuk i shpëtuan një politizimi të tejskajshëm. Specialistët e vërtetë u shprehën se ka pasur vendime të gabuara në këtë kongres, por kjo ngjarje ka pasur rëndësi shumë të madhe jo vetëm gjuhësore, por edhe historike, prandaj nuk duhet as të prekej, as të hidhej poshtë. Njerëz të etikës,

aspak specialistë të gjuhës, filluan të flasin jo me terma shkencore për këtë problem mbasi ata në shumicën më të madhe nuk kishin njohuri nga shkencë gjuhësore, por filluan të shajnë komunizmin dhe të thonë se ky kongres ka shkatërruar gjuhën shqipe dhe disa nga këta hodhën haptas idenë se "Gjuha gegërishte duhet të ishte gjuhë kombëtare dhe çdo gjë që ishte vendosur duhet të hidhej poshtë!"

Nga foltorja e parlamentit shqiptar, deputetë të mandatuar nga populli flasin në gjuhë dialektore dhe jo në gjuhën zyrtare të njohur dhe të miratuar zyrtarisht, duke u bërë një shembull i keq për drejtshkrimin dhe përdorimin e gjuhës shqipe. Po kështu, edhe shumë gazetarë dhe analistë, në emisionet radiofonike dhe televizive përdorin fjalë të huaja krejtësisht pa nevojë edhe kur fjalët shqipe ekzistojnë. Është për të ardhur keq, që në shkrimet dhe librat e tyre edhe persona me grada shkencore deri edhe Profesor Doktor, nuk i zbatojnë rregullat e miratuara të drejtshkrimit të gjuhës tonë dhe shkruajnë në dialektin e tyre. Shihet qartë që ky veprim kryhet në shenjë proteste ndaj mohimit të dialektit gegë dhe këtë në shumë raste e pohojnë me gojën e tyre.

2.3 A duhet shkruar gegërisht në publikime zyrtare dhe akademike?

Shkruesi i këtij shkrimi është nga Nikaj, një fis përfaqësues i popullsisë së Gegërisë ose i Gegnisë siç ju pëlqen të shkruajnë disa. Nëse do të nisesha nga kjo, shkrimi im do të duhej të shkruhej në dialektin gegë të gjuhës shqipe. Bëjmë pyetjen se çfarë do të ndodhte në shtete jo shumë të mëdha, p.sh. si Italia, ose Franca, ose në shtete të mëdha, si Rusia, Kina dhe SHBA-të nëse secili do të shkruante libra në dialektin e krahinës nga vjen? Rezultati do të ishte një krahurë e madhe gjuhësore, ku nuk do ta merrte vesh i pari të dytin.

Ju bëj pyetje atyre që pretendojnë se duhet të shkruhet në gegërishte dhe vetë shkruajnë në një variant të gegërishtes, që nuk e përfaqëson gjuhën e të gjithë atyre që e quajnë veten gegë, se a janë marrë vesh midis tyre, se cilin version të gegërishtes duhet të pranojnë shqiptarët?

Konsiderohet popullsi gege nga lumi Shkumbin e sipër ku përfshihet popullsia e Elbasanit, Tiranës, Krujës, Kavajës, Lezhës, Shkodrës, gjithë zona shqipfolëse në Mal të Zi, Puka, Tropoja, Mirdita, Mati, Dibra, Librazhdi dhe pothuajse e gjithë popullsia e kombësisë shqiptare e Kosovës dhe e Maqedonisë. Madje edhe popullsia e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanovcit. Dhe pyetja që shtroj këtu publikisht është se për cilën gegërishte e kanë fjalën këta zotërinj, për varantin e gjuhës shkodranishte apo atë të Mirditës, Dibërës dhe vendeve të tjera?

Nëse vendosim të hedhim poshtë gjuhën ekzistuese dhe të pranojmë në mënyrë unanime varantin gegë të gjuhës, do të kemi shumë probleme midis vetë gegëve, se si do ta shkruajmë fjalën *mirë*, do ta shkruajmë *majr*, *mëjr* apo në ndonjë formë tjetër. Nëse japim shembuj të tjerë të diversitetit të gjuhës shqipe në dialektin gegë, kesi shembujsh do të kishim pa fund.

Nisur nga sa parashtrova më sipër, jam i mendimit që të gjithë shqiptarët, kudo që ndodhen deri në fund

Ndoc Mulaj, krenaria e Alpeve Shqiptare dhe inteligjencës nikajmërturase

Të gjithë jemi kalimtarë në këtë botë, por jeta tokësore është ekzistenca dhe qenia jonë për atë çfarë jemi dhe çfarë bëjmë për vete, familjen, shoqërinë dhe të mirën publike në tërësi. Jeta të vë në shumë prova, e përmes sfidave të saj, maturohemi në shumë cilësi duke formësuar personalitetin, karakterin, familjen, identitetin dhe inteligjencën tonë, madje dikush duke u bërë edhe person publik si shërbëtor shoqëror që sjell një vlerë dhe dobi të caktuar në shërbim të të tjerëve. Këta njerëz pastaj bëhen misionarë të bashkësisë dhe shoqërisë në tërësi duke mos qenë më vetëm të vetes, por veprimtarë dhe vizionarë të gjithëkohshëm.

Në dekadën e fundit një intelektual fjalëpakët e punëshumë, ambasador i vërtetë i Alpeve Shqiptare, dhe jo vetëm kaq, u bë Ndoc Mulaj, duke u shfaqur si një eksplorues i paparë i çdo metri katror

njësie gjeografike, si përjetues i çdo mistri, mrekullie dhe befasi që të krijon humilimi i të vërtetave që fshihen në gjirin e natyrës, por edhe potenciale turistike dhe kulturës njerëzore në këto treva. Ai i shkeli me këmbë, si askush tjetër, pjesën verilindore e veriperëndimore të Shqipërisë, shoqëruar me mesazhe përkatëse në dobi të sensibilizimeve shoqërore përmes rrjeteve sociale.

Ndoci pati një formim të gjithanshëm: Në vitin 1992 pati mbaruar Akademinë e Policisë me sistem katërvjeçar; në Maltë, 2004, u trajnuar për "Menaxhim të kompanive të sigurimit"; në vitet 2007-2008 në Austri, Slloveni dhe Maqedoni u specializua si "Këshillues për çështje financiare - E&S, BNP PARIBAS, Internacional Investimet fund; në 2009-ën në Vjenë, Austri WIFI "Menaxhim biznesi, Menaxhim marketingu dhe Menaxhim projek-

tesh"; në vitin 2012, në Tiranë mbaroi "Akademia Diplomatike Shqiptare" për "Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci"; në Itali, në vitin 2013, nga Commissione Grotte E.Boegan, u certifikua si "Trajner i speleologjisë"; po ashtu në vitin 2013, nga Akademia Diplomatike Shqiptare, mori certifikimin "Menaxhim politik për lidhësin e ri", ndërsa në 2012-ën nga Fondacioni i Menaxhimit të Marrëveshjeve u titullua "Ndërmjetësues për menaxhim konfliktesh" e, gjithashtu, në 2013-ën, po në Vjenë, Austri, përsëri trajnim për WIFI, Ekspert i zhvillimit të turizmit, "Përcaktimi, studimi dhe markimi i resurseve, atraksioneve dhe shtigjeve turistike: "Menaxhimi i resurseve turistike, guida turistike, udhërrëfyes turistik, harta turistike".

Pati dhe disa botime, si: "Amaneti i pashkruar", "Nikaj-Mërturi, shpella dhe

legjendat", botimi dhe bashkëpunimi me revistën "Albanian-Alps", udhërrëfyes "PNR Nikaj-Mërturi", "Publicistikë 1", si dhe në proces botimi, plotësimi i "Amaneti i pashkruar", "Kënga majëkrahut, himni i malësorëve", "Ushqimi dhe pija tradicionale në Alpet Shqiptare", "Alpet Shqiptare, shpella" e të tjera.

Pavarësisht CV-së së pasur, Ndoci ishte protagonist i heshtur, i pareklamuar, në pozicione të ndryshme në Kosovë dhe Shqipëri, por ajo që e shoqëroi ishte pavarësia e punës, liria individuale e përzgjedhjes dhe kërkesa vetjake për të qenë vetëm i dobishëm në mjedise të ndryshme bashkësore. Duke sikur ishte i prirur, nga prejardhja e tij nikajmërturase, në kahje të lirisë së ndërgjegjes dhe veprimit, ndaj jo më kot at Gjon Shllaku pati thënë se "Këtu (nënkupto: Nikaj-Mërtur) të gjithë njerëzit

◀ të botës, duhet të respektojnë rregullat e drejtshkrimit të miratuar dhe shkrimet qoftë ato të administratës shtetërore dhe të medias, qoftë ato të shkrimeve publike të çfarëdo forme, duhet të shkruhen në gjuhën normative të miratuar dhe të pranuar zyrtarisht nga organizatet përkatëse.

2.4 A duhet të ndryshojë rregulli për shkrimin e gjuhës shqipe?

Për këtë problem ka dy grupe të mëdha që shfaqin mendime që e kundërshtojnë njëra tjetrën. Njëri grup është radikal në qëndrimin e tij, pretendon që Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe i vitit 1972 duhet të hidhet poshtë si një truk i organizuar nga shteti komunist i kohës dhe besnikët e atij regjimi, servilë deri në ekstrem të regjimit. Më tutje ata janë të mendimit të futet në përdorim dialekti gegë që kanë ata në mendjen e tyre, dialekti i banorëve të rrethit Shkodër. Por ata harrojnë se Shkodra nuk i ka përfaqësuar kurrë, as në ditët më të fuqishme të sajë, të gjitha krahinat gege të Shqipërisë në asnjë lloj problematike.

Grupi tjetër është më i moderuar, ata janë për rishikimin e vendimeve të Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe të vitit 1972, pa e hedhur poshtë këtë kongres. Ata janë shprehur se janë specialistët e gjuhës që duhet të na thonë se çfarë duhet të ndryshohet në ato vendime të mëparshme në mënyrë që gjuha shqipe të jetë e përsosur.

Unë nuk jam specialist i gjuhës dhe nuk di të jap mendime për atë problem, por duke dëgjuar pambarimisht diskutime për fjalët *kokë* dhe *Vlorë* jam bindur se diçka duhet të rregullohet, sepse nuk mund të thuhet *kokministër* për *kryeministër*, as *koktar* për *kryetar*. Edhe emri *Vlorë* ma merr mendja se duhet të shkruhet *Vlonë* mbasi fjala *vlonjat* nuk ka kuptim të shkruhet *vlorjat*.

Bazuar nga sa thamë në këtë paragraf, konkluzioni është që duhet vënë dorë me kujdes dhe pa pasion dhe mllëfe mbi

rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe. Këtë duhet ta bëjnë specialistët e gjuhës dhe jo politikanët as fundamentalistët e çfarëdo ngjyre që të jenë.

2.5 Cila është zgjidhja e këtij problemi?

Persona të ndryshëm kësaj pyetje do ti jepnin përgjigje nga më të ndryshme dhe zgjidhjet e propozuara mund të jenë në numër shumë të madh.

Lidhur me këtë problem unë kam propozimin se duhet të bëhet një kongres për drejtshkrimin e gjuhës shqipe. Këtë a arsyetoj nga dy faktor:

1. Sot gati 50 vjet mbas Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe kanë dalë problematika të reja, të cilave specialistët e fushës duhet tu japin zgjidhje. Me kalimin e kohës ndodhin ndryshime të cilat domosdo duhet të reflektohen në rregullat e shkrimit të gjuhës.

2. Për të reflektuar të gjitha ato shqetësime që paraqesin personat e ndryshëm qoftë specialist ose jo të gjuhësisë, duhet të studiohen shqetësime e paraqitura dhe duhet tu jepet përgjigje shkencore dhe institucionale, në mënyrë që në të ardhmen të mos kemi këso rastesh ku njëri shkruan në një formë dhe tjetri në një tjetër. Duhet rënë dakord që të gjitha palët ti binden një rregulli normativ për përdorimin e gjuhës.

Normalisht këtë problem duhet ta zgjidhin institucionet zyrtare të Shtetit Shqiptar siç janë Katedra e Gjuhës Shqipe e Universitetit të Tiranës, Akademia e Studimeve Albanologjike me Institutin e sajë të Gjuhës dhe të Letërsisë, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë.

Gjatë këtyre 30 vjetëve të fundit kemi vënë re një indiferencë të palejueshme ndaj dëmtimit të imazhit të gjuhës shqipe qoftë në media qoftë në botimet zyrtare dhe private.

Pothuajse në asnjë rast gjatë këtyre 30 vjetëve nuk kemi parë ndonjë reagim institucional të këtyre institucioneve për shkrimin në mënyrë të gabuar edhe të ak-

teve zyrtare të Qeverisë dhe të Parlamentit Shqiptar. Aktet zyrtare të publikuara në internet janë të mbushura plot me gabime drejtshkrimore dhe askush nuk mban përgjegjësi dhe asnjë institucion zyrtar nuk reagon ndaj këtij masakrimi që po i bëhet gjuhës sonë.

2.6 Përfundimi dhe rekomandimet

Nisur nga këto fakte që parashtrua më sipër jam i mendimit që shoqëria civile duhet të japë kontributin e sajë për këtë problem dhe ta thotë fuqishëm fjalën e sajë.

Mbasi shteti dhe organizmat zyrtarë që janë të specializuara për të bërë studimet gjuhësore, nuk po e marrin seriozisht problemin e ruajtjes dhe përmirësimit të gjuhës shqipe, i mbetet shoqërisë civile dhe organizatave jo qeveritare, me intelektualët më të aftë dhe më patriot që ti dalin për zot këtij problemi madhor të kombit tonë. Akademia e Shkencave Alternative "Rrënjët Tona", mund të jetë njëri nga këto subjekte, që mund ta marrë një nismë të tillë. Kjo do të arrihet nëse merren masat e nevojshme për krijimin e burimeve të nevojshme financiare dhe organizimin e specialistëve me qëllim final mbajtjen e një kongresi të ri të drejtshkrimit të gjuhës shqipe. Nëse sigurohen burimet e nevojshme financiare për këtë problem, jam i mendimit që në vija të përgjithshme të veprohet në këtë mënyrë:

1. Të vendoset data e mundshme e parashikuar për mbajtjen e këtij kongresi mbas jo më pak se 18 muaj nga data e publikimit të njoftimit.

2. Të njoftohen publikisht të gjithë personat e interesuar për ndryshimet gjuhësore brenda dhe jashtë Shqipërisë, se ata mund të përgatisin brenda një viti nga data e publikimit, material të shkruar për vërejtjet për mënyrën se si shkruhet sot gjuha dhe të paraqesin propozimet për ndryshime.

3. Të kërkohet nga specialistët më të mirë dhe të njohur si të tillë për gjuhën shqipe që të paraqesin me shkrim përvojat dhe mendimet e tyre për ndryshime.

4. Ata që nuk sjellin materialet e nevojshme brenda një viti, përjashtohen nga drejta e publikimit të punimeve ose vërejtjeve të tyre.

5. Në afatin kohor të 6 muajve, duhet të publikohen të plotat këto referate me të gjitha vërejtjet dhe propozimet e paraqitura. Materialet të botohen në formë libri dhe të shpërndahen para mbajtjes së kongresit.

6. Një komision specialistësh i Akademisë duhet të studiojë të gjitha materialet e paraqitura dhe të sjellë në Kongres për miratim një platformë zyrtare për ndryshimet e propozuara.

7. Në këtë kongres të jenë të ftuar për të marrë pjesë edhe institucionet zyrtare të shtetit shqiptar që merren me problemet gjuhësore.

8. Mbas një diskutimi të gjatë të problematikave të paraqitura, të kalohen për votim propozimet për ndryshimet që propozohen.

9. Të kenë të drejtë vote të gjithë ata persona që paraqesin për punimet e këtij kongresi një punim shkencor mbi çështjet e gjuhës mbi 30 faqe format A4.

10. Kongresi të jetë i publikuar nga mediat e shkruara dhe televizionet. Gjatë punimeve të kongresit nuk duhet lejuar të marrin pjesë ata që nuk kanë paraqitur materiale me përjashtim të personave personalitete, të cilët do të ftohen nga organizatorët.

Ky organizim do të kushtojë shumë mund dhe djersë edhe shumë para, por do të jetë një veprimtari e rëndësishme me interes kombëtar.

Jam i mendimit që edhe strukturat zyrtare të shtetit shqiptar do të jenë të detyruara ti njohin vendimet e këtij kongresi, i cili nuk duhet të ketë ndikime nga asnjë krah i politikës, por të jetë thellësisht me përmbajtje shkencore dhe kombëtare.

Ju faleminderit

◀ janë mbretën... Vetëm këtu asht i saktë koncepti i njeriut të lirë. Këtu janë njerëzit ma të lirë që ka bota!...Këtu secili njeri asht mbret më vete” (Pllumi, At Zef, 2006:53).

Me sa duket, djali i Mërturit dhe nipi i Nikajve (Mirashmarkaj), këtë koncept kishte parasysh në ndërgjegjen e tij që, pas 2010-ës, zgjodhi të ishte në lirinë e natyrës alpine, larg trazimeve dhe zhurmës metropolitane të të gjitha bindjeve, i joshur edhe nga pohimi i Dom Ndre Mjedës se “Kur ndiej malin kah flet shqip, s’më doket vetja se di shqip, por belbzoj shqip”, pohuar kjo nga ish-nxënësi i tij frati Pjetër Topalli. Në një intervistë të gushtit 2021, rreth katër muaj para se të ndërronte jetë, vetë Ndoci do të pohonte: “Ne jemi njerëz që nuk bëjmë dot pa lirinë tonë. Gjithsesi, çfarëdo që të ndodhë, unë do të vazhdoj të bëj detyrën time ndaj Alpeve, sepse ato janë bërë pjesë e pandashme e jetës sime”.

Më 1 dhjetor të vitit 2018, në simpoziumin “Nikaj-Mërturi në shekuj”, Ndoci pati mbajtur një kumtesë të zgjeruar, “Nikaj-Mërturi dhe turizmi”, ku do të shpaloste gjendjen në të cilën ndodhej kjo trevë para vitit 2011 dhe këndvështrimi, pothuajse zero, nga organizmat qeveritare, si dhe hapat ambiciozë që u hodhën pas 2011-ës nga “Qendra Alpe”, falë përkushtimit të vetë Ndocit, në bashkëlidhje me komunën e Torinos, Itali dhe Bashkëpunimin Gjerman për Shqipërinë “Giz Albania”.

Gjatë punës nismëtare nga “Qendra Alpe”, kur u ndërмор projekti “Zhvillimi i turizmit dhe mjedisit në qarkun e Kukësit” (prej 150 faqesh), treva e Nikaj-Mërturit përmendej vetëm me tri fjalë kyçe, pa asgjë konkrete në dobi të saj dhe konkretisht: “Nikaj-Mërturi”, “Lekbibaj” dhe “Curraj i Epërm”, pa detajuar asnjë lloj investimi prej një shume 1.137.000 eurosh. “... një harresë e vazhdueshme, shpeshherë mbase edhe e qëllimshme, nga qeveritarët e djeshëm dhe të sotëm” (Mulaj, Ndoc, 2019:713, në tërësi fq. 713-757).


Falë punës së drejtorit “Qendra Alpe”, zotit Ndoc Mulaj, hulumtimeve, eksplorimeve dhe studimeve të drejtpërdrejta në terrene alpine, siç është dhe Nikaj-Mërturi, i cili deri në vitin 2007 nuk gjendej në asnjë rrjet social, site, përveçse në Google ku shkruhej “Komuna Lekbibaj bën pjesë në qarkun e Kukësit”, u bë e mundur që, pas vitit 2011, me kërkesë të Qendrës Alpe në Torino, Itali, të dërgoheshin specialistë të turizmit, të cilët, bashkë me Ndocin, pasi përshkuan me këmbë tërë territorin nikajmërturase, hartuan dokumentin e parë zyrtar me burimet mjedisore, kulturore, historike, pika të forta dhe të dobëta, duke analizuar mundësitë e zhvillimit të turizmit.

Ndoci, duke qenë bir i kësaj treve, me inteligjencë të rrallë natyrore dhe diturore, akademike, nuk e filloi punën për famë vetjake, as për të krijuar pasuri. Së pari e shquante vullneti dhe idealizmi për të bërë diçka me një interes të gjerë publik që rrokte një popullsi mbi një milion banorë. Dhe hulumtimet, eksplorimet, studimet, analizat e bëra në këto terrene malore alpine, gjer në guvat më të thella, majat më të larta të thinjura me dëborë, filluan të japin rezultatet e para.

Mbështetur në projekte ndërshtetërore, në vitin 2012, përmes projektit “CABRA”,

u identifikuan shtëpitë e para bujtina për pritjen e turistëve, përcaktimi dhe markimi i shtigjeve me GPS dhe shenja identifikuese, duke u hapur rrugë ardhjes së miqve turistë në itinerarin Bëtoshtë-Qafa e Kolçit-Kuç- Qereç- Curraj-Vranë, me drejtues të “Giz Albania” dhe ambasadës gjermane. Falë përkushtimit të vetë Ndocit, me organizma qeveritare e joqeveritare, më 25 tetor, 2014, u arrit përurimi i shpalljes së Nikaj-Mërturit, “Nikaj-Mërturi Park Natyror Rajonal”, një arritje e jashtëzakonshme për këtë trevë.

Nga nëntori 2015 dhe gjer më 2017-ën, me interesimin dhe bashkëlidhjen e Ndoc Mulajt, me gazetarë të masmedias shqip-



tare dhe përfaqësues të agjencive turistike, u arrit që të vizitohet Brisa, Salca, Palçi, por edhe nga gazetarë të huaj gjermanë (22 të tillë) në itinerarin Brisë-Vranë



duke reklamuar këto atraksione turistike në mediat më prestigjioze gjermane. Gjithashtu speleologjia do të ishte një tjetër eksplorim, hulumtim, studim dhe reklamim i të huajve, bashkë me Ndocin, duke shënuar arritje dhe shpalosje të jashtëzakonshme në mediat italiane e më gjerë, theksuar me entuziazëm, p.sh. nga gjermani Hartmut Mueller se “Ju e keni Zvicrën këtu, në Alpet tuaja, prandaj jam i bindur se, në të ardhmen, rajoni i Nikaj-Mërturit do të tërheqë shumë turistë dhe vizitorë për të parë këtë pjesë unike të

Shqipërisë dhe botës dhe për të hapur disa mundësi ekonomike edhe për popullatën lokale” (Mulaj, Ndoc, 2019:717).

Përgjatë viteve 2016-2017 Ndoc Mulajt iu dha mundësia të ishte në krye të një grupi studimor duke përshkruar tërë rajonin e Alpeve Shqiptare, bujtinë më bujtinë, fshat më fshat, qafë më qafë e majë më majë, duke hulumtuar e studiuar kulturën, traditën, mikpritjen, biodiversitetin, shtigjet dhe atraksionet turistike, por Nikaj-Mërturi do të mbetej dashuria e tij e përhershme, aq sa do të pohonte me bindje të plotë se “...Nikaj-Mërturi është zona e Alpeve Shqiptare me më shumë atraksione turistike, ku turisti mund të kalojë

majëlarta, rudinat, blegtorja me kullosat e mira me variacione herbariumesh që japin pastaj bulmetin e pashoq që “ngjall të vdekurin”, siç thuhet në këto anë, bletët me mjaltin më konkurrues në Shqipëri, ujërat e kristalta kuruese për shëndetin që burojnë nga bjeshkët e larta, ku bora e re pushon mbi borën e vjetër, qarkuar si zonë edhe me kurorën e gështenjave që konkurrojnë në çdo treg e, të tëra këto e të tjera, përbëjnë një fushë magnetike që elektrizon vendasit dhe të huajt për të mos iu ndarë vizitës së kësaj treve alpine, si pjesa më joshëse e Alpeve.

Tërë ky potencial e më gjerë kaloi në skanerin e Ambasadorit të Alpeve, si zëdhënësi i parë, piskamë malesh nëpër mote, për t’i bërë këto treva të eposit legjendar të Mujit dhe Halilit të gumëzhijnë nga zërat njerëzorë, shqiptarë dhe të huaj, si perla të rralla të turizmit evropian. Çdo mik që u qaset këtyre anëve, gjen në kumtimin-guidë çdo të dhënë që i nevojitet, sintetizuar me imtësi nga dora dhe mendja e Ndoc Mulajt, fshat për fshat, lagje për lagje, evidentuar këto edhe përmes të huajve, që nga 1900-a me Franc Nopçën e deri më sot, me plotësimet moderne të aktualitetit, duke i reklamuar online në rrjetet sociale dhe mediumet shkencore.

Janë pikërisht këto veçori natyrore dhe njerëzore, të paktën mbi 100-vjeçare, që kanë joshur edhe të huajt, edhe vizitorë shqiptarë, që rimorën jetë nga eksplorimet, hulumtimet, studimet dhe reklamimet e papara të Ndoc Mulajt, në rreth dy dekada, konkretisht: si imazhe natyrore me monumentet përkatëse, arkitektura me shtëpi e kulla karakteristike, artizanati, shpella të ndryshme, guva bjeshkësh, ujëvara, folklori i pasur, veglat muzikore, etnografia, arti i të gatuarit me ushqimet tradicionale, recetat nikajmërturase dhe të banorëve alpinë në tërësi, pemëtaria, biodiversiteti, festat religjioze dhe veçoritë e tyre, turizmi kulturor, aftësitë akomoduese, shtigjet kryesore turistike, veçori udhëtimi (p.sh. 13 të tilla anëmbanë trevës), atraksionet më të veçanta turistike, si llojshmëri, veçanërisht:

Rrasa e Currajve – monument natyror; Burimi karstik i Qereshit; Gurrat e lumit – monument natyre; Ahishta “Gurra e Hasan Gashit” – monument natyre; Shkëmbi i Forcës (Curraj i Epërm) – monument natyre; Govata e Lumit të Zi; Ujëvara e Brisës; Kalaja e Lekës (Rajë); Syri Jeshil (mes Mulajve dhe Kuçit); Ujëvara e Mulajve; Logu i Gurrës (bjeshka e Salcës); Guri Murg (Palç); Shkëmbi Kullë (lagjia Prebibaj, Curraj i Epërm); Thana e Alisë, 136 vjeçare (Mulaj); Vosa e Kokërr Ndout (Bëtoshtë) e të tjera.

Speleologjia, si monumente natyrore të shumta jo vetëm në Shqipëri, por edhe në rajon, si: Shpella “Bira e Zezë” (Qeresh); Shpella e Shkambit të Rajës; Shpella e Boshit (Curraj i Epërm); Shpella e Kakverrit (Kakia e Nikajve, mbi faqen e majtë të Lumit të Pjasë, Curraj i Epërm); Shpella e lumit (Curraj i Epërm); Shpella e Drelës (Curraj i Epërm); Shpella e Alisë (afër Qafës së Pipit, mbi Mulaj); Shpella Muldea (mes Vorrit të Frarit dhe Kalldrëmave); Shpella e Kolë Gegës (afër qendrës Lekbibaj, mes Vargut dhe Palçit); Shpella e Kaponit (përgjatë rrugës Mëserr-Palç, mbi një kodër të

DOSJA HETIMORE E REVIZIONISTIT MIRASH ZEF PREKA

-Komitetit qarkor Shqipëria e lirë dënon pa mëshirë idealet diktatoriale të Enver Hoxhës!-

(vijon nga numri 218,
muaji dhjetor 2021)

Xhek London te romani i famshëm “Thundra e hekurt” ka venë në gojën heroit të tij romantik shprehjen filozofike. Kur nuk mendoj për të ardhmen, rri e mendoj për atë që nuk është më. Ernest Evarhardi ishte një nga udhëheqësit me të aftë në përgatitjen e lëvizjes punëtore kundër “Thundrës së hekurt” “Në vitet njëzet tridhjetë të shekullit të 20-të Evarhardi kishte një plan madhështorë

sa nuk mund të zbatohet nga gjenia e një njeriu të vetëm. Edhe Mirash Zef Preka pesëdhjetë vite me vonë kishte në mendje të sfidonte Thundrën e kuqe, që nuk mund të realizohej nga një zë i vetëm në shkretëtirën shqiptare. Mirash Zefi me dhimbje të madhe me idealizëm dhe vullnet stoik hyri në një valle aventurë-madhe për riskun e vet. Shqiponja ime le te fluturojë me krahë të pa lodhshëm drejt diellit të përhershëm të idealit flakadan të lirisë njerëzore. Ai i tha vetes nuk mund të ri duarkryq dhe te pres mrekullinë nga

Zotat e qiejve. Zëri dhe vokacioni i brendshëm e thirri Mirash Zefin, i cili pa u trembur u shpërvol dhe hyri bash kundër rrjedhës në kulmin e lumin të turbulluar. Vozitjes së tij rebele ai kushtoi djalërinë e vet. Guximi i tij i peshuar me kandarin ekstrem të kohës u konsiderua sa paturpësi aq dhe çmenduri, por përtej miopisë ideologjike ky ishte tipari i natyrshëm i Mirash Zef Prekes. Ai ishte thjeshtë i drejtë i pa trembur dhe nuk i pëlqente mendimi uniform i tufës. Mirash Zefi ishte një militant i deklaruar, por me vetëdije sfidoi

tabutë e kohës dhe u rreshtua në kampin e kundërt dhe me qëndrimin e tij sfidues u tha engjëjve mashtrues të pushtetit. Ju keni braktise tokën e ngurtë dhe vërtetë jeni ngjitur në ajër si tullumbace, duke përdorur ideologjinë dhe mashtrimin si mekanizëm fluturimi. Kundër rebelimit të djalit plagëprishës regjimi kohës ktheu majën e shpatës së zjarrtë që pasqyrohet krejt saktë në dosjen hetimore të revizionistit Mirash Zef Preka

vogël, rrethuar me gështenja); Shpella e Fratit (15 minuta nga kisha e Palçit, shtegu i vjetër që lidh Palç-Salcë); Shpella e Kokonës (Brisë); Shpella Mark (Shtegu i Zhigut, Curraj i Epërm); Shpella e Shtarzës

përmes artit poetik të Martin Camajit do të shprehej: «Kur të vdes, le të bahem bar / në malet e mia në pranverë / në vjeshtë do të bahem farë // Kur të vdes, le të bahem ujë / e fryma ëme avull / në fushë do të bie shi // Kur të vdes, le të bahem

laj, Ndoc: Intervista, gusht, 2021).

Por... vjen një ditë. Ah, Munellë! I pate thënë Dom Gjergjit “... me mue nuk mbetet kush në mal...”. Vërtet me Ty nuk mbeti kush në mal, as në ditën e atij Moti të Madh, ndërsa vetë u bërë njësh me malin prej thirrjes së tij: “Sonte, o Ndoc, do jesh përgjithmonë me ne, se nuk marrim musht pa Ty! Eja në Lumninë e Hyjit, se Ti i deshe si askush tjetër natyrën, malet, alpet që Unë i krijova për Ju!”

Ishe bërë avokati më i përsosur i bukurisë së malit dhe i mistereve të tij. Apeli Juaj ishte hyjnor për ta ruajtur atë, gjallesat e tij, se i Lumi na dha ne tokën për t’u kujdesur, jo për ta shkatërruar, ndaj Ndocit i dhimbsej gjithçka, çdo pemë apo kafshë e egër. Madje (27 nëntor, 2021) nga shtegtimi në mal, kur gjen një mace të egër të rënë në kurth, shkruan: “Kjo macë e egër kësaj radhe ishte me fat që u takua me mua në shtegtimin tim të fundit. E gjeta në një kurthë hekururi ... hapa kurthën me këmbë dhe ajo shkoj në punë të vet, në mal, atje ku e ka vendin... por të paktën lironi këto kafshë të pafajshme... Shtet, o shtet, bëje edhe ti punën tënde për të cilën paguhesh me taksat tona, mbroji pyjet dhe bashkë me to edhe banorët e tyre, kafshët e egra...”

E ja, pra, Ndoc Mulaj, iku në amshim, duke lënë pas një vepër të pavdekshme që e mbajnë mbi supe malet dhe banorët e Shqipërisë së Epërme që ngritën mrrrolshëm kreshtat duke lëshuar vikamën gjëmëmadhe për alpinistin e fshehtësisë së tyre që ua njohu kodin më mirë se askush tjetër. E këto male ia lëshove mbi shpinë familjes tënde të shenjtë për të cilën bërë aq shumë dhe që do ndjejnë përjetësisht mungesën tënde, por gjeni yt dhe i trungut tënd e njeh mirë qëndrësën, përbalimin e dhembjes për ta kthyer në forcë, moral, që gjurmën tënde njerëzore, intelektuale ta kthejnë në dritë hyjnore për ta zditur me shumë veprën Tënde dhe projektet që prisnin materializim konkret, të thëna e të pathëna, madje në gjalljen tënde, autorit të këtij kumtimi i pate pohuar:

“Një rrugë makine nga Logu i Qafës së Kolçit, në vijë të drejtë e në Mulaj-Qeresh, e deri të “Bira e Zezë”, do të ishte një mrekulli turistike që do sillte mijëra turistë. – Një mik i imi italian më pati pohuar se, po të jetë infrastruktura e duhur, vetëm kjo shpellë do të mbante

krejt rrethin e Tropojës”. Kjo rrugë, përveç të tjerash, ishte edhe pengu Yt i madh, por... largimi nga kjo botë vjen kur Ti nuk e pret...

Ishe orëmadh, por edhe gjëmëmadh. E kush nuk e përjetoi dhimbjen për ty?! Vëllezërit dhe motrat, bashkëmoshatarë, kushërinj, dajallarët e drejtpërdrejtë, por edhe tërë mëhalla Mirashmarkaj, që të kishin nip fort të dashur, shokë, miq të vjetër e të rinj, profesorë universitetesh, turistë e alpinistë, gazetarë, udhëtarë të tutë brenda e jashtë vendit, kryeqytetas dhe zyrtarë dashamirës, por dhe elita e qytetit të Pukës që bëri gjithçka në lehtësim të dhimbjes njerëzore për humbjen Tënde të papritur në majën e Munellës. Për këtë qytet, dhe rreth në tërësi, flisje me shumë pasion, kur pohoj: “Puka është vendi më i mirë dhe më i favorshëm për turizmin familjar... ajo çka është më kryesorja për turistët. Puka ka njerëzit më mikpritës në këtë vend, ka shtigjet më të lehta dhe më të përshtatshme për të gjitha kategoritë dhe moshat” (Mulaj, Ndoc: Intervista, gusht, 2021).

Vlerësimet e shumta njerëzore dhe zyrtare ndaj ndihmesës së vlerëshme që dha Ndoc Mulaj në gjallje të tij rreth promovimit të vlerave natyrore, turizmit malor, vlerave të traditës dhe kulturës ishish të menjëhershme. Kështu që bashkia e qytetit Bajram Curri më 27 janar, 2022 dhe ajo e Pukës më 18 shkurt e vlerësojnë me titullin “Qytetar nderi”, ndërsa po më 27 janar bashkia Tiranë i jep titullin “Mentor nderi”, çka tregon përkushtimin fizik, intelektual të Ndocit në dobi të një komuniteti shumë të gjerë në tërë potencialet e tij, si reklamë brenda e jashtë vendit.

E tash në tokën e amshuar Dreni, Ambasadori dhe krenaria e Alpeve shqiptare na kumbon në gjithëkohësi: - Amanet, more shtegtari i malit, vendas apo i huaj! Kur të kalosh këtyre shtigjeve, ku Unë i markova me dorën time, në qofsh duke folur apo kënduar, apo duke qenë i vetmuar në ecjen tënde, lëshoma një zë, sikur thërrasin malet me piskamë: - O Ndoc Mulaj, more, ku je! – Dhe unë do të jem bashkudhëtari Juaj i përherëshëm...

Prof. Ded Qokaj, Mars 2022



(Vranë) [Mulaj, Ndoc, 2019: 734-755].

Spikatje të veçantë për syrin e turistit marrin edhe kullat, si institucione kulturore që mbartin histori njerëzore dhe arkitekturore me rrezatime shekullore trashëgimie, si p.sh.: Kulla e Thepit, rreth 180-vjeçare, Kulla e Mirash Gjoni, Kulla e Dedë Miftarit, Kulla e Kolë Qunit, Kulla te shtëpia e Dedë Prelës, Kulla te shtëpia e Sokol Macellit (Curraj i Epërm); Kulla e Fazli Miftarit, Kulla e Sukullarit (Qereç); Kulla e Fazli Tahirit (Mulaj); Kulla e Qëndresës (Brisë); Kulla e Delí Tahirit (Salcë); Kulla e Kurtesh Kurtit, rreth 300-vjeçare (Lekbibaj).

Vizioni, formimi intelektual i Ndocit, njohjet dhe lidhjet me personalitete të ndryshme zyrtare dhe vullnetarë dashamirës për t’u dhënë jetë masiveve të mëdha të Alpeve Shqiptare dhe banorëve të tyre, u bënë pjesë e një projekti gjigand (në miniaturë), i cili hap pas hapi po jepte rezultate, sidomos: Puka, Tropoja në tërësi, veçantë Nikaj-Mërturi, Thethi, Shala (lumi i Shalës), Shoshi, Malësia e Madhe e të tjera. Lidhja me malin u bë shtëpi e dytë për eksploruesin dhe Reklamuesin e Alpeve.

Një muaj e gjysmë para se të mbyllte sytë, Ambasadori i Alpeve, me sa duket në ndjeshmërinë e Tij shpirtërore, sikur e kishte kapluar dashuria e tejskajshme për t’ju qasur përjetësisht Malit, ngaqë

gur / në skajin e vendit tim / të qindroja kufi”. Dhe kufiri i Tij mbeti në Munellë të Pukës, më 30 nëntor, 2021, duke u mbështjellë përjetësisht në gjirin e malit, si simbol i një dashurie të perëndishme ndaj tij.

Largimi i parakohshëm nga kjo botë ishte humbje e madhe për familjen, të afërmit, dashamirët, bashkëpunëtorët e tij në eksplorimet alpine, brenda e jashtë Shqipërisë. Ishte një humbje e madhe edhe për trevën nikajmërturase, si pjesë e projektit Nikaj-Mërturi, Park Natyror Rajonal (2014) apo inicimeve për motivacionin presidencial Nikaj-Mërturi “Nderi i Kombit” (2017), si dhe projekte të tjera ambicioze infrastrukturore që trevat alpine të ktheheshin në atraksione turistike ku do dyndeshin mbi një milion banorë, vendas dhe të huaj, si: bukuria natyrore me monumente të jashtëzakonshme, turizëm kulturor, religjioz etj.

Falë punës në ekip të Ndocit, u markuan me qindra kilometra rrugëkalime malore dhe shtigje alpine, madje vetëm në Pukë janë hapur nga zeroja 207 km shtigje turistike. U zbuluan dhe u eksploruan me dhjetëra shpella ku, vetëm në shpellën “Bira e zezë”, është ecur rreth 6500 m, si dhe zbritja deri te “Mrizi i zanave”, një tjetër shpellë “... për t’u shtuar këtij “Oazi” të shenjtë të kulinarisë shqiptare edhe një atraksion tjetër kaq të rëndësishëm turistik” (Mu-

◀ **DUKE SHFLETUAR DOSJEN Nr. 92** Akt akuzë kundër të pandehurve tradhtarë Mirash Zef Preka dhe Martin Sokol Leka. Të akuzuar në bazë të nenit 73/I-12 dhe 100 të KP Organet hetuesisë së Degës së P. Brendshme Shkodër me dt. 30.08 1975 filluan hetimet dhe morën në përgjegjësi penale të pandehurin Mirash Zef Preka me banim në Shllak dhe Martin Sokol Lekën me banim në Nicaj Shalë. I pandehuri Mirash Zef Preka ndonëse vjen nga një sh-trese fshatare, por te ai është konservuar në një armiqësi të thellë ndaj pushtetit popullor dhe fitoreve të revolucionit tonë popullor në të gjitha fushat e jetës. I pandehuri Martin Sokol Leka në opinionin shoqëror të Shalës është njohur si person e familje pro pushtetit, por në fakt i pandehuri në brendi ka ushqyer armiqësi të theksuar kundër pushtetit dhe për këtë arsye ka qenë i brumosur me koncepte e zakone antisocialiste dhe reaksionare. Siç rezulton nga procesi hetimor të pandehurit Mirash Zef Preka dhe Martin Sokoli kanë qenë në pikëpamje të përbashkëta kundër-revolucionare, duke qene të njohur dhe të lidhur miqësisht kanë pasur mendime dhe mbajtur qëndrime të përbashkëta armiqësore kundër zhvillimit të luftës së klasave. Të dëshpëruar dhe të zemëruar nga masat e goditjeve të rënda që i dha partia grupit komplotist të Beqir Ballukut, menduan të ndërmerrenin veprimet e tyre kundër partisë dhe qeverisë....

Në muaj prill 1975 i pandehuri Mirash Zef Preka shkoi në Dukagjin nga Kooperativa e Shllakut për të marrë një sasi misri, por qëllimi ishte për të takuar dhe biseduar me të pandehurin tjetër Martin Sokoli për të vazhduar dhe thelluar veprimtarinë armiqësore. Kur kthehet prej Shoshi për në Shllak, në Breg të Lumit i pandehuri Mirash Zefi Takohet me shokun e tij të pandehurin Martin Sokoli të cilit i kërkon të dhëna se si po shkojnë punët. Në këtë takim vendosin që të vazhdojnë dhe të shumëfishojnë traktet armiqësore. I pandehuri Mirash Zef Preka i jep dy copë trakte Martin Sokolit të cilat ai menjëherë i pranoi dhe i mori:

PËRMBAJTJA E TRAKTIT

Thirrje: "Komitetit Qarkor Shqipëria e lirë i bën thirrje gjithë popullit shqiptarë të ngrihen në këmbë me vendosmëri kundër Partisë e Qeverisë për të nxjerrë, për ta nxjerrë Shqipërinë nga vuajtjet. Komitetit qarkor Shqipëria e lirë dënon pa mëshirë idealet diktatoriale të Enver Hoxhës. Rrofshin idealet demokratike dhe përparimtare..."

Të dy të pandehurit diskutuan se këto trakte do zgjeroheshin dhe do ta shtrinin veprimtarinë e tyre në shkallë rrethi dhe më gjerë. ...

Qëllimi hedhjes së trakteve me përmbajtje armiqësore ka qenë për të krijuar panik ne masat e popullatë sidomos turbullira ne mendjet e te rinjve.

Mirash Zef Preka ka qenë ideatori dhe përpilues i këtij trakti, nga dosja hetimore nuk rezulton as një akuzë as fakt se dy të pandehurit kanë qene të nxitur nga agjenturat e huaja siç edhe u propagandua pas arrestimit të tyre për t'i damkosur zi e më zi në sy të opinionit publik. Analiza pirografe e shkrimit dhe gjurmët dakti-

loskopike të zbuluar ne traket e postuara korrespondonin saktësisht me gishtërinjve e dy të pandehurve. Të vetëdijshëm se gjendeshin përballë një vepre penale të provuar të pandehurit kanë treguar linjën kronologjike të ngjarjes duke pranuar akuzën për veprën penale që kishin kryer me dashje dhe bindje të plotë politike.



Lula e Mirash Zef Preka

I pandehuri Martin Sokoli ka deklarimin në hetuesi: Në pranverë 1975, Mirashi ka ardhur në Shosh me marre farë misri. Në Beg Lumi erdhi e më takoi mua aty kemi diskutuar për të shkruar trakte me përmbajtje armiqësore, madje këtu Mirashi më ka dhanë tekstin për ta shkruar e shumëfishuar. Unë i mora dhe i kam shumëfishuar. Mbaj mend se kemi diskutuar dhe rënë dakord për t'i dërguar këto trakte në Komitetin e Rinisë, në Ndërmarrje shkolle dhe kooperativa të rrethit Shkodër.... I pandehuri Martin Sokoli ka qenë konsekuent në zbatimin e detyrave që kam marrë nga pandehuri Mirash Zef Preka, shkroi dhe shumëfishoi këto trakte dhe qëndroi në pritje të urdhrit të Mirashit për të vepruar.... Rreth 15 ditëshit të parë të muajt korrik 1975 i pandehuri Martin Sokoli me pretekstin e punës nisete vjen në Shkodër. Këtu mbërri në orët e mbrëmjes dhe shkoi menjëherë e hell në kutinë postare traktet e përgatitura në adrese të komiteteve te rinisë. Largohet prej andej aty dhe gjithë natën qarkullon nëpër qytetin e Shkodrës duke hedhur trakte ne vende te dukshme. Në orët e mëngjesit pasi kishte plotësuar misionin qe kishte menjëherë zhduket dhe nisete në këmbë për në Dukagjin. për të humbur gjurmët e krimet...

I pyetur për këtë gjë i pandehuri Martin Sokoli ka deklaruar se:- Se rreth orës 20-të kam shkruar ne postë dhe zarfet i kam hedhur ne kutinë postare me adrese të disa komiteteve te rinise se zonave, kam marrë rrugën pas shtëpisë së oficerëve kam hedhur tre-katet cope trakte ne dy vende të dukshme, pastaj te truma e dugajve të reja.

I pandehuri Mirash Zef Preka pasi ka mësuar se bashkëpunëtori tij Martin Sokoli ka kryer me përpikëri detyrën e ngarkuar mëngjesin e datës 31korrik 1975 doli në qendër të Shllakut qarkulloi, kontrolloi dhe pasi u sigurua se nuk kishte lëvizje menjëherë shkoi afër P.T.T dhe

afishoi në mur dhe shpërndau në natyre një sasi traktesh armiqësore. Tre dite me vone nga rasti i parë, kur i pandehuri Mirash Zefi konstatoi se populli nuk reagoi dhe nuk pati ndonjë shqetësim vendosi dhe shpërndau pjesën tjetër te trakteve që kishte rezerve të cilat i vendosi para spitalit te qendrës së Shllakut. Nga postimi

dhe afishimi i trakteve të jashtëzakonshme, nuk pati as një reagim publik veç ndonjë pëshpëritje me gjysmë zëri tek tuk. Përveç të burgosurve të ngujuar ne arteriet e galerive të nëntokës, Shqipëria tjetër nuk kishte gojë. Shqipëria tjetër mendonte dhe besonte vetëm tek shoku Enver dhe nënëmadhja parti, Zoti dhe zonja e tyre për të cilët luteshin e thoshin uratë. Traktet shkuan në adresat e postuara, por askush nuk u solidarizua. Mali, guri e druri madje dhe nata pa hënë, kishin sy e veshë. Vigjencës së tyre nuk i shpëtoi herezia e "Iaritur" Zefi-Sokoli. Sigurimi me qetësi olimpikë i shytoj dy të mallkuarit duke rënë prehe e një kontrollit fizik të befasishëm ku sigurua dhe sekuestrua prova akute materiale. Të thërrisje rroftë Shqipëria e lirë pa Enver Hoxhën me 1975 ishte një soj si të rrokulliseshë natën pa hënë nga maja e Qafë Tërthores dhe përfundojte në gjerbej të Kaprrësë, sipër Syrit të Kaltër.

Gjykata e Rrethit Shkodër me vendim nr. 64 datë 09.03. 1976 e dënoi armikun e Popullit dhe të Partisë, Mirash Zef Prekën me 12 vjet burgim që vuajti kokërr më kokërr dhe i shkaktuan një përthyerje vertikale tektonike të fatit të vet dhe familjes së tij. "Çmenduria" idealiste, apo "tradhtia mosmirënjohëse" ndaj parimeve ideologjike M-L, ishte një trimëri romantike, njësoj që të hapësh një llogore për mes një fushe të minuarën në një stuhi bombardimesh ajrore. Lufta dhe burgu janë arena burrërisë së vërtetë. Askund njeriu më mik për tjetrin dhe burrë nder burra nuk bëhet si nder ditët ma të vështira të jetës. Në as një sitë ma të imtë nuk sitet burrëria se në dallgët e luftës dhe shtigjet e panjohura të hapsanës. Njeriu i idealeve të vrara Mirash Zefi u sitë për mbi një dekadë dhe doli si miell Venediku. Qëndroi në burgjet më të rënda të diktaturës i etiketuar si revizionist. Atje pa, dëgjoi, studioi, reflektoi dhe qëndroi si çeliku i mirë që sa do të skuqet e të ftohet nuk

e bjerrë uj. U njoh me socialdemokrat-in dhe babanë e disidencës shqiptare Zef Mala, me revizionistet Koço Tashko, Gjin Marku, Tobdi Lubonja, Fadil Paçrami, debatoi dhe polemizoi me shumë legalistë e ballistë, të përvuajtur dhe intelektual, sfidaat që guxuan si vetë ai. Sa e sa here i zbardhi agimi pa vu gjumë në sy tue fol për

probleme teologjike filozofike me klerikët të mëndje thinjur, At Gege Lumaj, At Pjeter Meshkalla, At Zef Pëllumbi, Dom Simon Jubani e të tjerë. Qau e qeshi me përçmim për ordiner e të rëndomtë, por edhe për analfabet llafazan pa bindje, që kishin përfunduar në si rrodhja pas topeve të dashit në stanin e armiqve politik. Sjellja e tij shembullore, alegoria, dashuria, njerëzia, zotësia plot thjeshtësi e benë të çmohej e të nderohej në armatën e tij të gjerë bashkëvajtjes. Terri as lagështia e galerive, pesha rraskapitëse e vagonëve, as zemra e plagosur për familjen e ndrymë si bleta në zgjoj nuk mëritën me ja zbehë vetitë që pati kur i shkeli këmba në atë ferr të djajve heretik. Në pikëpamje politike qe idealist socialdemokrat i moderuar. Mirash Zefi as kur qe këmbë mbaja këmbë në karrigen e kuadrit politik, as në as mes telave me gjemba lidhur këmbë e duar me hekurat e renda të armikut të klasës as në pranverën zhgënjyese të post nëntëdhjetë, nuk diti me qenë gjysmak as fanatik i verbër. Diti me mbajt me drejtpeshimin rendin dhe kostumin e vlerave, shpirtërore e njerëzore.

DRITA E ERRËSIRËS SE JETËS MIRASH ZEFIT

Çfarë do të ishte jeta pa gruan?! As gjë. Jetën e lindë, i jep gji e ushqen dhe edukon si askush vetëm nëna. Çfarë di ishte Mirash Zefi pa Lulë Mark Çardakun?! Po do ishte një fatkeq në errësirë me një thyerje dyfishë kurrizore të pa shërueshme të fatit. Bashkëshortja dhe bashkëluftëtarja më e madhe jetës i erdhi si një vegim i rastësishëm i porositur nga të tjerët ende pa ardhur në jetë. Në vjeshtën e vitit 1932 Zef Preka i Rrethit të Lekajve së bashku me të shoqen Palinë Gjonja shkojnë me pa meshë te kisha e Bregut të Lumit. Te blini në skaj të Urës se Shalës takohet me dashamirin e Mark Duf Çardakun (nga shtëpia e madhe me za Gjon Ndreut të Pecnika-

Familja e Gjon Markokajt, që ndërton ura komunikimi e mbjell dashuri

Prolog

Hapësirat e shtrira në brigjet e lumenjve në shekuj kanë qenë më të populluara e më të parapëlqyera për një jetesë më të lehtë e një zhvillim më të hovshëm. Një dukuri e tillë ka ndodhur edhe në Luginën e Valbonës e Drinit, me ngulmime të hershme e përparim të admirueshëm për kohën, histori të spikatur, tradita të shquara pozitive, me vatra të dijes e të kulturës, që zënë fill në thellësi të mijëvjeçarit të kaluar. Dëshmi e kësaj është edhe Fierza e sotme e krahinat rreth saj, të shtrira në të dy anët e kësaj lugine me bukuri përrallore e të tjera banime mes Valbonës e Drinit që dalin në dokumentet e hershëm arkivorë. Po sjell në vëmendje Dioqezën e Pultit, themeluar qysh me 887, si një rajon unik me orientim perëndimor, ku i dha hapësirë shkrimit dhe mësimi të gjuhës shqipe, kohën tjetër kur këto krahina ishin nën administrimin e Pjetër Spanit, me objektet historike e ato të kultit, fortesat e fortifikimet e shumta, vlera të tjera të çmueshme e pasuri të padiskutueshme; vizitat, shërbesat e udhëtimet e famshme të frymëzuara nga atdhedashuria e madhe: të Benedikt Orsinit, Don Shtjefën Jubanit, Frang Bardhit, Pjetër Mazrekut, Pjetër

Bogdanit, Gjergj Bardhit e të tjerë deri ata më të vonshmit si Pater Zef Pëllumbi, Patër Dionis Maka e Patër Gegë Luma, që sot, më gjithë meritat e shquara, nuk janë objekt i shkrimit tim.

Në fokus kam një pasuri e vlerë tjetër, pa të cilën nuk do të kishim as histori, as kulturë, as gjuhë e as Shqipëri e kjo është atdhedashuria, uniteti e urat që lidhin individë, mbrojnë familje e fshatra, krijojnë e farketojnë besimin e besën mes krahinash e këto ngjizin kombin e ndjenjat kombëtare përballë pushtuesve shekullorë e pse jo, argatëve e shërbëtorëve vendas, që tentojnë apo heqin gurë në themelet tona të ngritura me aq gjak e sakrificë.

U farketuan në shekuj me bekimin e Zotit, u mëkua e u rrit me dashuri në familjet e thjeshta shqiptare, me sakrificë e kosto shumë të rënda, sa proceset stërmunduese buzë lumenjve a në galeritë e thella vdekjeprurëse sterrë të zeza për prodhimin e arit. Këto vlera shkëlqejnë e çmohen më shumë se ari i gjithë botës, për çdo atdhetar të kalitur në zjarrin e egër të historisë, përballë rrebesheve që zhdukën e shuan jo vetëm vlera, por edhe popuj.

Mbijetoi Malësia, kjo kështjellë e pashoqe e lirisë, ku u mbrojtën këto vlera

në kulla guri.

Pa mohuar heroizmin masiv përballë bishave, ku mund të veçosh e përmendësh me dhjetëra e qindra familje, dua të veçoj njërin prej tyre, mu buzë Valbonës ujë kaltër, një kullë e një familje fjalë pakë e punë shumë, që punoi ndër breza, me pasionin e kujdesin më të madh, për të krijuar ura komunikimi, për të farketuar e kalitur unitetin e atdhedashurinë, si ai kopshtari i palodhur ku çdo ditë, pak e nga pak, heq barërat e këqija, ferrat e degët e thata, mbjellë fidanë të rijnë, u lufton sëmundjet e u shërben më gjithë shpirt, pa tam-tame, pa u ndërë e vetëmburrur, si prindi rritë fëmijën, me përkushtimin e nënës për gjakun e gjakut të vet.

Të flasësh për Fierzën e krahinat përreth, për Rajën ku lindi e u rrit e të mos takosh Gjon Ndue Markokën, do të mbeshte shumë debitor ndaj lexuesve; sado dije të kesh, para tij ke nevojë të dëgjosh e të shënosh, për jetën e tij frymëzuese, për rrugëtimin e këtyre krahinave, për vështirësitë, përballjet e arritjet. Vetë jeta e Gjonit kaloi nëpër shumë peripeci, të përpjeta e të tatëpjeta, pengesa e suksese që duhen vlerësuar e marrë shembull nga brezat.

E kam njohur prej vitesh, madje kur unë isha nxënës në filllore e ai mësues në Tetaj (një fshat kufitar me vendlindjen time). Më kujtohet portreti i tij fizik e pse jo edhe moral: komunikues e i ëmbël, jo hijerëndë si disa mësues pedant, njerëzor, dashamirës e me fjalë të matura, me një trup mesatar, disi i mbushur që ngjante me një mundës apo shtangist, biond, me flokë të dendur, trup të fortë e të zhdërvjelltë, të cilin e kujtoj kur bënim piknikë, kur kishin mbledhje mësuesit a fshati, në veprimtaritë kulturore e sportive, gjatë takimeve të tjera apo kur shkoja tek Peshk Arifi ku ai banonte. Në Pedagogji thuhet se një shembull vlen sa 100 leksione.

Figura e tij kudo ngjallte admirim e respekt: në fshat, në shkollë, në familje e shoqëri. Ne nxënësit ëndërronim e na frymëzonte ta kishim model. Unë, duke u rritur e shkolluar, duke e njohur jetën më mirë e përpjekur edhe për të gjykuar me objektivitet, nuk u zhgënjëva në ato përjetime të fëmijërisë për këtë mësues; vitet kalonin e ai lartësohej, kontributet e sukseset ishin të prekshme: në mësimin e edukimin e brezit të ri, si veprimtarë i shquar shoqëror, në krijimin e një familje shembullore, me një

jeve). Edhe Marku po shkonte në kishë bashkë me gruan e tij të fisme Linë Gjokën bijë Shoshi. Lina ishte motra e Gjokë Nikës që këndohej në eposin e besës së maleve tona bashkë me Babun Celin, kurse gjyshi Deli Nika i Celajve qe internue nga turku në Kerr Torobullus me 1871. Tue pritë me fillue mesha të përkëdhelur nga rrezet e një diellit të ëmbël vjeshtorë ndezën nga një cigare duhani dhe banë kuvend plot çiltërsi. Mana me çka po më sheh syni gratë i paskeni te dyja shtatzana i tha: - Marku dashamirët.

-Marka e di se ke sy velet, por kur flet me burra mos i lësho sytë nga gratë!

-Qebesa Zefo kjo asht punë si duket dhe thash dashamirësisë vjetër të ja shtojmë edhe një spik miqësie te re nëse asht thenë me i lindë njenit djalë e tjetrit çikël!

-Qyshe ta ketë shkrua Lumnia u baftë ja ktheu Zefi tue thithë cigaren që nuk e ndante prej buze!

-Zoti e ka nda pleqninë e vet dhe nuk shkrua as një herë gabim, por qysh po shkruajmë unë e ti: - pveti Marku me kambëngulje?

-Po presim sa të çelin njomza se këtu po jena more Mark!

-Qebesa e Zotit për hatër nuk pres me fillua kjo meshë pa ra në godi e me u ba miq kreje! Zefi bani edhe një thithje ma të fortë të cigares, tymi kapërdui me etje e çoj në mushkëri. Shtëllunga aromatike mbasi bani xhiron e detyruar u kthye mbrapa dhe kaloi në të vetmin shtegkalim të lirë për hundesh të duhanxhiut të etshëm dhe tymosi oxhaku në cegëm

-Po kje thenë me ndodhë si dëshiron ti për hair na kjoftë miqësia ja priti Zefi dhe shtrini dorën i lumturuar Markut! "Basti" i një miqësie të re u pre. Vetëm pas pak muajsh gruaja e Mark Difti i lindi një va-

zë, që pagëzua me emrin Lulë dhe gruaja e Zefit Prekës lindi djalë, që ia ngjitem Mirash. Lula dhe Mirashi lindën të fejuar dhe te dashuruar njëkohësisht sipas besëlidhjes së vjetër atnore. Kjo ndodhi nuk është fantazi përrallesh imagjinare të netëve të gjata të dimrit, por një realitet i shkruar me frymë perëndie apo nga pushteti prindëror, që rezultoi fatsjellës në vazhdimësinë e jetës familjare të Mirash Zef Prekës. Nga martesë e Mirashit me Lulën erdhën në jetë pesë fëmijë shëmbëlltë e cilësive më të mira të prindërve të tyre. Nikolini, (sot jeton në Itali), Anila e Altini (në Belgjikë), Vera në Kiras, ndërsa një vajzë pati vdekë në moshë minore. Lula ishte dhe mbeti një grua fisnike me pak shoqe si vetja, nënë jashtëzakonisht e përkushtuar, punëtore e ballë djersitur e aftë me jetua në shkëmb të gjallë, por dhe edukatore tradicionale shembullore. Me urtësi me forcë karakteri në vitet ma të bukura të jetës i ra mbi supë një barrë sa ortiqet e Beshkës së Madhe. Nuk u ligështua, përkundrazi në situatat më dramatike u bë më shumë burrë se grua. Për 12 vjet rresht qe Zot e Zonjë shtëpie dhe heroinë e një familje që mbijetoi e papërlyer në valët e diskriminimit, politik, ekonomik dhe social që e goditën. Nuk u qa as nuk u qurros duke mallkuar tmerrin e pa merituar që i ra për pjesë. -Ndaje burrin, distancohu nga ai armik i partisë, pushtetit por edhe familjes, e shantazhuan Lulën, por prej so-koleshës morën përgjigjen stoike: - Kurrë pa vdekë se ndaj shokun e jetës që më zgjodhi baba! Ai nuk ka vdekë dhe kurrë nuk do ta turpëroi për së gjalli! Burgu për burra është, fëmijët do t'i rris jo të lumtur por me nderë pa ju bë urë askujt, por edhe Mirashin e ndrymë në kafaz do ta mbaj ma mirë se vetën. Qindra e qindra herë kafshatën u dha fëmijëve, punoj erre e terë

me djersë e thonj të dorës, që ata të mos u bënte kusht me gisht e të mos u thoshin njerëzit më keqardhje të shkretët. La vetin mangut, por trastën e mbushi plot që Mirashit në burg të mos i mungonin duhani, kafja sheqeri dhe harxhet qe duhet të merret një i burgosur i kohës nga familja.

Lulë Markja qe drita në errësirën e jetës dramatike të idealist disident të Mirash Zef Preka.

Mirashi në burg kaloi ditë të errëta e net pa fund në pranga i përbuzur si anti-adhetarë dhe armik i popullit. Diktatura e zhveshi nga gjithçka, por pasuria intelektuale dhe karakteri i tij qëndrësëtar u shtua dita ditës. Mirash Zefi në burgjet politike diktatoriale hyri djalë i pjekur idealist dhe doli burrë mëndjethinjur Mirash Zefin pas "eksplorimit" rraskapitës u ngjiti në sipërfaqe dhe me trishtim konstatoi se rrokulloja në rendje lirë e shpëtimtarit të shumë pritur socialist, ishte më afër greminës se kurrë dhe shumë herë më laskaruese se kur e përzunë nga arena mbidheshme dhe vijoi salvimin e nëndheshme. Ujkonja e kuqe që dikur kafshonte pa mëshirë këdo që i dilte përpara, tashmë e ngordhur e shëmtuar kockë lëkurë, u sulmua, e u shqua me grykësi prej hienave triumfuese. Mirashi kishte sakrifikuar vitet më bukura të jetës për vrasjen bishës së tërbuar, por një fund të tillë nuk e kishte dëshiruar. Disidenti vetmitarë i shartuar me tharme elitare nuk njësiohej me turmën. Turma për të ishte e rrezikshme dhe tmerrësisht e frikshme. Mendim kolektiv e kishte katandisë në ketë qorrsovak vendin e tij. Të ashtuquajtura lëvizja e bekuar demokratike që shpërtheu si uragan kafshues, shihte një mendësi ëndërrimtare kolektive veshur me një aureolë të shenjtë nga engjëj mashtrues që farën e bekuar mbillnin nder ferra. Mirash Zefi e donin ta kishin në llogoren e vet secili tabor

politik në luftën e tyre cinike me ushte e shpatë duke u lutur e thirrur për një Shqipëri demokratike me aspirata Evropiane. Jo, jo ai nuk ishte renegat as hero pas mejdanit. Mirash Zefi ishte marinarë i vjetër që nuk ju frikësua natës në det. Nuk u bë palë më askënd as nuk i dha rast askujt t'i gërvishte plagët e vjetra. Ai në vetminë e tij ëndërrimtare thoshte:

-Kur u ngrita unë ku ishit o burrat e dheut. Po ju, që më mallkuat, çfarë po kërkoni sot me lugë në brez?! Jo mana jo, nuk mund të rreshtohem me kameleonë pa as një ideal. Nuk shoh të majtë as të djathtë të vërtetë, shoh vetëm dy bija të ngjashme në mendësi pabesi dhe mëkate si nena që i polli. Faleminderit por nuk kam moshë të bëhem pis tha, idealisti në mënyre refuzive ndaj çdo oferte politike.

Mirash Zefi i mbylli sytë i rrethuar prej familjareve miqve të dashur, me 16 qershor të vitit 1999. U varros me gjamën epike të burrave të motit i përcjellë me nderime nga një lumë njerëzish prej gjitha trevave të Shkodër Loces. Meshën mortore e drejtoi miku dhe bashkëvajtjes emblematik Dom Simom Jubani.

Intelektuali disident i thjeshtë dhe orator proverbial, prehet i qetë nder varret e Rmajit, i cili për së gjalli skaliti epitafin e varrit të vet. "Një jetë e luftuar përmes vuajtjeve të rënda morale, politike e fizike, pa ditë ç'është frika për idealet e tija më të epërme humane".

Mirash Zefi shkoi duke i lenë trashëgim familjes uratën. Jeta është kryevepër hyjnore që na jepet vetëm një herë. Pa liri, nderë dhe shëndet jeta asht tragjedi satanike.

◀ “investim” të gjatë, madje shumë të gjatë, i cili ka dhënë e po jep frytet e dëshiruara që kërkon prindi. Janë me dhjetëra e qindra nxënës e kuadro, deri edhe në pozicione e dikastere të rëndësishme të vendit, që vlerësojnë punën e mësuesit të tyre e i janë mirënjohës për jetë, që u ka dhënë rrugën e mbarë me punën e pasionin e tij, me shembullin pozitiv që i ka frymëzuar.

Treveza e blinit

Në mjediset e jashtme të lokalit Markokaj (por edhe brenda), përballë atij sheshi në qendër të të cilit kanë mbjellë e rritur një bli goxha të madh, ku kryqëzohen shumë rrugë e qarkullojnë me qindra makina, sheh nën kurorën e njërit prej blirëve më të bukur zbukurues, edhe një tavolinë disi të veçuar, për herë e mbushur plot, ku flitet e kuvendohet, bëhet humor e batuta gazmore, diskutohet e jepen mendime për shumë fusha të jetës. E quajnë “Treveza e blinit” apo “Treveza e Gjonit”, se ai është në fokus për shumë orë, është magneti e vlera që mbledh gjatë gjithë ditës individë të veçantë e grupe të tjera zinxhirë.

Është kjo trevezë bujare (se i zoti i saj vendos edhe veton në të vetmin rast) që rrezaton shumë vlera pozitive, që mbjellë e shpërndanë harmoni e unitet përballë rasteve të tjera dashakeqe që manifestohen e shfaqen mjerisht edhe në shoqërinë tonë.

Ka pasur edhe takime të rastësishme “aksidentale” mes personazhesh me konflikte prej vitesh, ku Gjoni me ndjenjën e humanizmit e aftësitë e psikologut popullor ka arritur mjeshtërisht edhe t’i pajtojë, duke ndërtuar mbi greminën ndjellakeqe urat e komunikimit, aq të domosdoshme për shoqërinë tonë. Përfytyroni për një çast, sikur çdo njëri prej nesh, të kontribuonte çdo ditë pak e nga pak, pa hile, por me drejtësinë e ndershmërinë e Gjonit. Ka qenë e është zotëri burrë; djemtë e familja e tij (dhe jo vetëm) e kanë idhull e asgjë nuk kursejnë që ai ta ndjejë veten sa më mirë fizikisht e moralisht. Shpërblimi më i mirë mbi të gjitha është se ata po ecin nën shembullin e mësimit e tij. Si pa dashje mu kujtua filmi shumë edukativ “Një baba tepër”, prej të cilit duhet të nxjerrim shumë mësim, sidomos brezi i ri.

Gjoni mësues, edukator e veprimtar shoqëror

Siç e thamë edhe më sipër, rrugëtimi i Gjonit nuk ka qenë i lehtë, por me shumë vështirësi e peripeci. Kujton me mirënjohje edhe atë ditë të largët, kur jeta e tij hyri në një hulli të re, kur në shtëpinë e tij erdhën Kolë Hajdar Ramaj e Ukë Matosh Markokaj e i propozuan vazhdimin e shkollës.

Me moshë disi më të rritur, me këmbënguljen e tij dhe largpamësin e të atit e nënës arsimdashëse, në vitin 1952 filloi shkollën e Mesme Pedagogjike me bazë filllore “Ndrec Ndue Gjoka”, të cilën e mbaron me rezultate të larta pas 4 vitesh duke filluar punë në Salcë të zonës Nikaj-Mertur, larg vendbanimit mbi 5 orë rrugë në këmbë, në kushte të vështira e pa kurrfarë infrastrukture.

Kudo punoi e shkoi, larg apo afër vendbanimit, punoi me pasion e përkushtim shembullorë, me ndërgjegje e me ndershmëri, duke fituar jo vetëm respektin e brezave që

mësoi e edukoi, por edhe të komunitetit. Krahas familjes e detyrës shtetërore, vazhdimisht e shoqëronte edhe një shqetësim tjetër serioz; rritja e nivelit arsimor e profesional. Vitet e kishin bërë punën e vet, por nuk ia kishin zbehur dëshirën, as thyer vullnetin e kjo ishte një garanci e sigurte për arritjen e synimeve të guximshme.

Së pari, plotëson Shkollën e Mesme Pedagogjike 4-vjeçare e të gjithë e vlerësuan këmbënguljen e suksesin e tij. Si



ëndërr në sirtarë, ai kishte edhe mbarimin e shkollës së lartë, e cila zbehej e lëkundej nga pengesat e kohës e ata që kënaqeshin me pak (madje edhe dashamirë) duke u përpjekur t’ia frenonin e shuanin këtë ëndërr që kërkonte shumë sakrifica fizike, mendore e monetare. Disa vite para se të dilte në pension, ai mbaron suksesshëm edhe arsimin e lartë për histori-geografi. Vetëm ata që kanë qenë dëshmitarë të atyre viteve, nxënës e student të arsimuar pa shkëputje nga puna, e besojnë këtë “aventurë shumë të guximshme” e plot mundime.

Vitet kalonin e personaliteti i tij rritej e kalitej; nuk u mbyll në guackën e një mësuesi brenda 4 mureve të klasës, thjeshtë si një mësimdhënës, por figura e tij rrezatonte shumë më gjerë; shikimi e kontributi i tij shtihet larg, edhe në fusha të tjera dobiprurëse të shoqërisë. Sigurisht se në qendër kishte detyrën shtetërore, për të cilën paguhej e u bë një ndër mësuesit më të mirë të Tropojës.

Puna e tij, nga pjesa dërmuese vlerësohej e promovohet, por kishte edhe segmente të veçantë që përpiqeshin me ia errësuar për arsye xhelozie a për ndonjë hije në biografi, veprën e tij shumë dimensionale, gjë që u dështoi. Mbase dikujt i duket si propagandë, por unë po sjell vetëm disa fakte:

- Në vitet 1978 e 1983 është dekoruar me medaljen “Për shërbime të shquara shtetërore e shoqërore”; - 1985 e 2013 nga Ministria e Arsimit merr respektivisht distinktivin “Mësues i dalluar” e “Mirënjohje si mësues i dalluar”; - 2017, në 100-vjeto-

rin e hapjes së Shkollës së parë Shqipe në Tropojë (Gjonpepaj) “Çertifikatë Mirënjohje”; në 80-vjetorin e lindjes Bashkia i jep titullin “Qytetarë nderi i Tropojës”.

Është dalluar edhe si një ndër Pajtimtarët më me reputacion e të suksesshëm në konfliktet e trashëguara para viteve ’90 e ato të lindura në vitet e Tranzicionit.

Gjatë viteve të fundit ka shkruar e botuar 14 libra të gjinive e zhanreve të ndryshme, ku spikat më së miri edhe

trimëri, me gra fisnike e punëtore të palodhura, por edhe për qëndresë të fortë ndaj çdo pushtuesi, për fortësa e fortifikime, për ndërtime interesante me gur, të pathyeshme përballë çdo stuhie. Thuhet se Kulla e Lulash Nikë Markokajt (tre katesh në formë rrethore), e Kolë Ukës, e Beqir Ndue Pepkolajt dhe Zef Mark Kukajt, secila me dhjetëra frëngji për t’u mbrojtur nga çdo armik, kur me 1845 mësnyë forcat vandale të Maxharr Pashës, nuk mundën as me i pushtua, as me i djegë.

Dikush mbase nuk e ka problem, por dera e Pjertër e Kolë Ndout e pasardhësve të saj, e ka mision ta ruaj traditën pozitive e ta lartësojë atë edhe në këto kohë shumë dinamike e me lëvizje të mëdha.

Në kushtet e atyre kohëve të vështira asnjëherë nuk hoqën dorë nga ekonomia, se për ndryshe duhej të hiqje dorë nga jeta; nuk kishte të ardhura e burime të tjera jetese.

Mjerisht sot shumë fshatra pothuajse i kanë hequr fare bagëtitë e imta.

Aq i lidhur, sidomos pranverë e deri në vjeshtë e vonë, ishte me bjeshkën, Koren e Mërturit, sa edhe sot ruhen toponimet “Stani i Kolë Ndout, Rupa e Shkalla e Kolë Ndout”. Vërtetë deri në vitin 1971, kur brigjet e Drinit e Valbonës u lidhën me urë për herë të parë në historinë e këtyre krahinave, patën pritje e përcjellë me fisnikëri çdo mik e nevojtar të shumtë në çdo kohë, në dimrat me suferinë e stuhitë e mëdha vjeshtë-pranvere, kur ata lumenjtë bëheshin, jo vetëm të frikshëm, por tmerr e me viktima të herëpashershme. Nuk mburret kjo familje, po flasin bashkëvendësit (edhe këta me mikpritje të jashtëzakonshme) për rastet kur Drini i egër në raste vërshimesh binte lisa e shkulte shkëmbin; as që bëhej fjalë për ta kaluar me ato mjete rrethore primitive me argsh apo rrëshkë mbi trina të thurura me degë lisi. Rastet pothuajse ishin të përditshme, madje edhe me denduri, se jeta vazhdonte: me raste gëzimi e miqësish, për festa, për lindje e për vdekje, për të sëmure që dergjeshin a të tjera arsye. Aq të pritshëm e të gjindshim, aq bujarë e miqësor, sa sot as që mund të përfytyrohet se sa sakrifikuon për të tjerët. Për këto troje, strehë e ngrohtë për çdo njeri të kamur e të skamur (të pasur e të varfër) edhe sot, ata që jetojnë, shprehin mirënjohje maksimale.

Me të drejtë thuhet se, nuk dimë ku shkojmë, pa ditur se nga vimë. Vizionar e me vështrimin para, përsëri me shumë sinqeritet kujton të kaluarën e ato që ia përcollën gjyshi e babai të cilin e citon “E di shpinë me gja e mallë shumë, me kulla e stane, me shumë berre, mbi 100 dhenë, me mushkë e me kali, por edhe në vorfni t’ madhe, me thanë mos me muajt me pritë 3 vetë me shëllinë, pak djathë e kos”. Sigurisht se jeta shpesh është si valët e detit, me batica e zbatice, por, ajo mos bjerrje e vlerave në vështirësi të tejskajshme e mos harresa, janë investimi më madhor për ato arritje që kanë sot.

Gjovalini e Gjini-model në marrëdhëniet me njerëzit

Qysh kur u hap rruga Fierzë-Lekbibaj (1979) më ka rastisë t’i takoj e t’i njoh më nga afër.

Atë vëllain tjetër Arbenin, të cilin e njoh pak për arsye të moshës më të vogël e emigracionit, kam dëgjuar fjalë të mira, për përpjekjet e mbijetesën si emigrant prej disa vitesh. Sigurisht se kam dëshirë ta njoh më nga afër, por gëzohem se njoh

formimi e autobiografia e tij; përveç vlerave artistike, në ato studime e krijime, gjen të mishëruar edhe traditat e shquara të malësorëve, atdhedashurinë, problemet sociale e filozofinë popullore, vlera që do t’u shërbejnë brezave.

Nuk është mburravec, por flet e gjykon me realizëm: e mban mend veten fëmijë në ato brigje e shpate edhe këmbëzbathur e deri vonë duke luajtur me top me lecka, duke u quajtur fitore kur dolën opingat e llastikut e ato të tjerat, opingat e thesit “disi më bashkëkohore” (si të gjithë moshatarët), duke rritur e mbarështuar bagëtinë, duke punuar me kazmë e lopatë, por edhe me kostum e kravatë, i veshur hijshëm e me shije, në auditorët e shkollës, si nxënës e student, por edhe si mësimdhënës; ky është si po dua ta them “Gjoni gjitharmësh” i kompletuar si intelektual, por edhe për gjykime e biseda në dhomat e burrave, në “Universitetin e Malësisë” ku mori dijet e para e më vonë dha kontribute të vyera.

Edhe pse po u afrohet 85 viteve, është aktiv e me shëndet të mirë fizik e mendor. Shpesh e sheh në mëngjes apo mbrëmje duke ecur në rrugën e asfaltuar vitet e fundit e, në orët e tjera, duke shkruar e lexuar, apo duke u marrë me ndonjë punë të thjeshtë fizike a zbukuruar mjedisin rrethues të shtëpisë e lokalit.

Disa fjalë për traditën e hareshme familjare

Për Rajën mund të shkruash e të veçosh shumë gjëra, një vend i vogël me aq shumë histori, me burra të shquar për pashi e për

veprën e tij: një shtëpi-vilë 3 katesh të projektuar e ndërtuar me djersën e ballit, me aq pasion e dashuri, po në trojet e të parëve. Më shumë se fjalët flasin veprat.

Përvoja popullore ka thënë se është provë e rëndë shtëpia në drum (*rrugë*) e lisi derë farkës; në rastin e parë, në çdo orë të ditës e natës, vit pas viti e dekadë pas dekadë, je në provë si shtëpi për t'u ndëruar apo turpëruar e rasti tjetër deri në tjetërsim a asgjësim nga sëpatat vrastare.

Tranzicioni - një sprovë tjetër edhe më e rëndë. U përballën përsëri me probleme të reja serioze, të fshehta e të hapura, por nuk e humbën asnjëherë drejtpeshimin e rrugën e vlerave. Vitet e gjata të këtyre ndryshimeve transformuese kanë qenë një sprovë e gjatë dhe e vështirë, ku u shpalosën vlera e antivlera. Krijimi i hapësirave që të jep Demokracia, tek disa nuk u mirëpërdorë, por u shpërdorua rëndë e solli probleme të mëdha shoqërore.

Familja e Gjonit gjatë gjithëkohës nuk u lëkund as u tundua nga veprimet e joshjet abuzive për të përfituar padrejtësisht në kurriz të shoqërisë, për t'u përfshirë a lidhur me persona apo segmente problematike të dyshimtë, shkelës të ligjit e normave pozitive.

Aty buzë Valbonës, në trojet shekullore të të parëve, me forcat e veta ngritën një biznes modest, me hapësira të kufizuara për familjen, në favor të mjediseve të mjaftueshme publike, të respektimit ligjor për rrugët, lulishtet apo treguesve të tjerë që duhen për një qytetë bashkëkohore e të perspektives, çka është vlerësuar e janë përgëzuar edhe nga strukturat shtetërore.

Me kontributet e tyre fizike e monetare, e kontribuuan e kontribuojnë gjatë gjithë kohës për një mjedis rrethues sa më të kulturuar e çlodhës, për ruajtjen e mirëmbajtjen e tij, me ambicie në rritje për t'u bërë shembull pozitiv për klientët e popullatën.

Shërbimi i kulturuar e miqësor, pa mendjemadhësi e mospërfillje, po me thjeshtësi e dashamirësi e me çmime të arsyeshme, ua ka rritur e shtuar respektin e mirënjohjen. Është befasuese e jo fort e normale, në çdo orë të ditës e në çdo stinë, të gatshëm e të çiltër, modest e dashamirës për t'u shërbyer njerëzve. Asnjëherë e në asnjë rast nuk shprehën, por as u lexova në sy e fytyrë, përgjigje të ashpra, lodhje e pakënaqësi, as përballë sjelljeve që meritonin të kundërtën. Këto qëndrime me fjalë e me vepra "edhe tek më të fortët e problematikët" ndikuan në uljen e gjakrave e krijimin e një klime e qetësie publike të admirueshme.

Ashtu si miku, që sheh e gjykon për gjithçka, edhe klienti i tillë është. Gjithfarë nevojash e kërkesash, që nuk janë pjesë e detyrës: për informacione e orientime nga më të ndryshmet, strehime plaçkash, shërbime me makinë e të tjera. Edhe një objekt të ndërtuar në tokat e tyre gjatë ndërtimit të H/C e privatizuan për nevojat e veta, por e shndërruan në një hotel modest për t'iu gjetur pranë kosovarëve gjatë Luftës, për vizitorë, për ndonjë zgjidhje a ndihmë të karakterit humanitarë, për raste gëzimi a hidhërimi, për të sëmurë e deri edhe për aventurier të natyrës; më shumë e hapën për sa thashë më sipër, se sa për arsye fitimi. Dihet nga të gjithë se një familje e punësuar e strehuar në mjediset e H/C para viteve 1990, me pamundësi për t'u shpërngulur e siste-

muar diku tjetër, jeton sot me mirëkuptimin e të zotëve, po në pronat e kësaj familje bujare.

Në fshat ku lindën e u burruan, nga fëmijë e deri në moshën që kanë sot, kanë qenë model e nuk kanë sjellë asnjë shqetësim, përkundrazi kanë kontribuar e dhënë shembull pozitiv aty ku e ka lypë nevoja e tradita.

Pa e idealizuar, të bie në sy edhe një dukuri pozitive: mirëkuptimi e harmonia e



biznesit privat, duke pranuar me qytetari rregullat e tregut e të mbijetesës, ku prijnë vëllezërit Markokaj.

Me miqtë e shtëpisë, aty ku kanë dhënë e marrë, kanë ekzistuar e ekzistojnë marrëdhënie të ndërsjella miqësore me lidhje shpirtërore të përzemërta, të sinqerta e pa kurrfarë hileje.

I zoti i shtëpisë patjetër është arkitekti i lidhjeve të shëndosha miqësore, por vëmendësia është meritë e Gjovalinit e Gjinit dhe nuseve të reja. Ata miq të përmendur, hijeshojnë e nderojnë çdo sofër e kuvend burrash, shumicën e të cilëve edhe unë i kam njohur nga afër (apo ndërë zërin e historitë): Tahir Nikë Bushati e Metë Alija (Lekbibaj e Peraj), Adem Sadiku, Vatë Mirash Vukaj, Prelë Sejdi Bala, Martin Zef Geci (Curraj Epër), Mirash Ndou-Vuksanaj, Prelë Nika-Mëzi, Martin Prela-Fierzë, Mhill Marashi-Bugjon, Ndrekë Nuçi-Miliska e të tjerë.

Nuk do të ishte e hijshme as objektive pa përmendur edhe zonjat e nderuara të kësaj shtëpie që kanë qëndruar e qëndrojnë me dinjitet krahas burrave që përmendëm, për punën e tyre dobiprurëse e të heshtur, në lartësinë e fisnikërisë prej nga erdhën e ku krijuan një jetë të re (Zoja, Vera e Liria).

Më gëzon shumë fakti e më jep shpresë për vazhdimësi nga ato që pashë disa herë kur kam qëndruar në këto lokale, kur kam parë edhe rininë e kësaj familje, nipër e mbesa, madje edhe një brez më larg. Ata kanë synime e objektiva ambicioze për një

jetë më të mirë, ndaj kanë marrë rrugët e migrimit e emigrimit (deri në Amerikën e largët), të cilët ruajnë e manifestojnë traditën e vlerat bashkëkohore, pa harruar lidhjet me vendlindjen e respektin familjar e shoqëror: Renato, Arturi, Borisi, Sidorela, Roberti, Aneta e të tjera.

Raja, për vetë pozicionin gjeografik ku gjendet, kufizohet me Dushaj e Geghysen, sot të besimit mysliman. Në mënyrë të ndërsjellë janë shquar këto bashkësi për

bukura të Amerikës, Kaliforninë e Las Vegasin e famshëm e të tjera vende shumë të bukura. Vend më të bukur se vendlindjen time "Rajën e Mërturit" për shpirtin tim, për qetësinë time e gjumin e ëmbël nuk kam mundur me gjete askund tjetër". Nuk do mend se kështu do të ishte për këtë atdhetar dhe djemtë e tij, të lindur e të rritur në këtë natyrë magjepsëse në brigjet e Valbonës, që lëshuan shtat nga brigjet e lumit të kristaltë e deri në Koren e Mërturit, në atë bjeshkë, ndonëse me gurë e disi e thatë, ka një ëmbëlsi të pashpjegueshme, larushi të pashoqe barërash, bimësh e pyjesh, një klimë të përshatshme e të shëndetshme në çdo stinë, ku rriten e kultivohen gjithfarë prodhimesh bujqësore e blegtorale bio, origjinale e me shije të veçantë, atribut që ja jep toka e dielli jetëdhënës që lind e ndriçon qysh herët me rrezet e tij, që dhurojnë gjithfarë bereqeti.

Me shikimin para, retrospektivë për Fierzën

Shkrimtari dhe disidenti i shquar rus Aleksandër Sozhenicini thotë: "Nëse merremi vetëm me të kaluarën, na plas njëri sy, po nëse harrojmë të kaluarën, na plasin të dy".

Vitet e fundit, si rezultat i kërkimeve e studimeve në arkivat jashtë vendit (më së shumti nga zoti M. Palnikaj), ka pasur zbulime e ndriçime të reja që hedhin dritë për ngulmimet, popullimin e zhvillimin e këtyre zonave, veçanërisht në gjysmën e dytë të mijëvjeçarit të dytë, duke shmanhur deformimet e deritanishme e trajtimet jo shkencore.

Gjoni, bashkë me kolegë e intelektualë të zonës e më gjerë, kanë kontribuar jo vetëm për të përcuar tek brezi i ri e të tjerë më të moshuar të vërtetat e historisë, por kanë dhënë ndihmesë edhe vetë në këtë fushë për njohjen, ruajtjen e promovimin e traditave pozitive duke krijuar një klimë optimale, përballë të mirave, por edhe erozionit që sjell hapja me botën.

Disa herë kam qenë vetë dëshmitarë e pjesëmarrës aktiv në tavolina pune apo edhe në mjedise argëtuese ku temë e ditës, përveç problemeve aktuale, ka qenë edhe e kaluara e këtyre brigjeve, njohja e vendlindjes si histori e si gjeografi, madje viheshin edhe baste për ndodhi, data e personazhe.

Ky mikromjedis miqësor, pse jo edhe me vlera njohëse e shkencore, tregon për një emancipim të shoqërisë, për gjykime objektive e mirënjohje, për kontributin e brezave që i ndërtuan këto vepra me shumë sakrificë.

Pas një sprove të gjatë e të vështirë njeriu e meriton edhe një çlodhje, po zhvillimet e vrullshme nuk të japin kohë as të marrësh frymë.

Edhe 10 vitet e ndërtimit të H/C të Fierzës, kur në pikun e punimeve punonin afër 10 000 vetë, shembulli i kësaj familje që dinjitoz në të gjitha drejtimet

Në epiqendër Fierza e viteve 1970-1980, kur u manifestua ai heroizëm popullor masiv, dolën në pah aftësitë e personelit inxhinier- teknik të atyre viteve, ndonëse jo sa duhet të vlerësuar moralisht e materialisht.

Në kujtesën e më të moshuarve, por edhe brezit të ri të asaj kohe, që tashmë janë bërë prindër e mbase gjyshër, ruhen me dhjetëra e me qindra emra që shtohen e plotësohen nga bashkëbiseduesit, çka është e vështirë t'i

VAKSINA KUNDER COVID-19 KA EFEKT MË TË ZGJATUR, SE SA MENDOHEJ..

Me gjithë rënien e shpejte të numrit të antikorpeve disa muaj pas dozës së dyte, ana tjetër e medaljes VAKSINA KUNDER COVID-19 –KA EFEKT MË TË ZGJATUR, SE SA MENDOHEJ, për përgjigjen imunitare është mbetja e larte për të paktën 9 muaj, gjë që mbron kundër formave të renda të covid-19, por që mbron dhe kundër infektimit kundër shtimit Omikron. Dyshimet notojnë nga mungesa e provave, ku shihet e rëndësishme përgjigja imunitare e gjeneruar nga vaksina me ARN, mbrojtja e tyre duket se mbetet e vlefshme për një afat të gjate. Megjithatë rënia e shpejte e antikorpeve që vërehet mbas 6 muajsh dhe që ka mbrojtje të paktën kundër infektimit të konstatuar, që vjen në këtë periudhë sjell friken se efikasiteti i vaksinës behet shpejt i pamjaftueshëm.

Një studim i ri tregon se, me gjithë këtë rënie të antikorpeve, ne përfundojmë një mbrojtje shumë të mirë kundër formave

të renda të corona-virusit, të paktën për 9 muaj. Dhe kjo ndodh në saj të limfocideve-T vepruese. Këto qeliza imunitare



mbeten të mobilizuara për një kohe të gjate mbas vaksinimit dhe ne mbrohemi kësajsoj edhe nga Omikron, i cili u fshihet, maskohet antikorpeve, por jo limfocideve-T. Dy doza me ARN mbrojnë kundër formave të renda për 9 muaj. Kërkimet e universitetit të Karolines së Veriut

në SHBA, analizuan të dhënat e 10 milion shtetasve amerikan, që rreth gjysma e tyre kanë qenë të vaksinuar me dy doza vaksine ARN- Pfizer (Artikulli i botuar me 12.01.2022 në revistën NEYM).

Shkencëtarët kanë konstatuar se mbrojtja kundër infektimit simptomatik u ul nga 95% në 66% për Pfizer dhe për Moderna në 80% mbas 7 muajve. Një ulje korreluese e rënies së numrit të antikorpeve

të renda ku është qëllimi kryesor i vaksinës mbetet i larte dhe me dy doza. Ky fenomen shpjegohet me gjithë uljen e antikorpeve në mbështetjen e një përgjigjeje imunitare pikërisht nga limfocitet-T. Po ky efikasitet ulet më shpejt tek personat mbi 65 vjeç, tek të cilët doza përforcuese e (rapel) është e domosdoshme për të siguruar një mbrojtje optimale. Studimi vetëm i antikorpeve nuk na lejon të precizojmë efektivitetin e vaksinës.

Varianti Omicron shtron problem shpesh ndaj vaksinës, sepse mutacionet lejojnë ti fshehin antikorpeve të gjeneruara nga vaksina. Sipas studimeve invitro të prodhuara nga dy doza vaksine nuk arrijnë të neutralizojnë gjithë këto variante, megjithatë studimet e publikuara nuk vërtetojnë akoma mbrojtjen kundër Omicron, e cila është afro 30% me dy doza Pfizer dhe me dozën e trete kjo mbrojtje arrin 62% nga që antikorpet kundërshtar, limfocite-T nuk e njohin shumë mirë Omicronin me mutacionet e veta, dhe preket në mënyrë unike një minoritet i rritur të njohur qelizor nga (20 -30%) sipas të dhënave të SHBA dhe Afrikës së Jugut. Kjo përgjigje imunitare e limfocideve-T njih akoma shumë më mirë dhe na mbron kundër infektimit Omicron, sidomos ndaj formave të renda, që shkakton ky variant.

Mbrojtja e vaksinës është pra, më e gjere dhe më e zgjatur sesa studimi thjesht i antikorpeve, ku mund të besoni.

Përgatiti Dr. Med. Ndue Nikaj, PATHOLOG-INTERNIST, Shkodër

shënosh të gjithë, por e pamundur të mos veçosh disa. Ndjejë keqardhje për ata që nuk i shënoj dot, por dhembje për ata që nuk jetojnë.

Sot kujtohen me respekt brigadat me brigadierë Shaban Gjokën, Ashim Zyberin, Xhaferr Melin, Dali Lika e të tjera (nga Kukësi e Dibra) e me qindra punëtorë që dhanë e sakrifkuan aq shumë e nuk u shpërblyen sa duhet, madje 52 punonjës humbën edhe jetën.

Tek shumë veta ruhen e kujtohen me shumë respekt emra të shquar si inxhinier e drejtues të këtij H/C, me kontribute të shquara, përkushtim, guxim e aftësi profesionale: Projektuesit Petrit Radovicka, Egon Gjadri, Farudin Hoxha e të tjerë, disa drejtues: Miço Veshi, Muhedin Muça, Emin Musliu, Kiço Negovani, Ismail Ahmeti, Besnik Bekteshi e të tjerë.

Po kam dëshirë që për lexuesin të sjellë të gatshme edhe disa data e ngjarje:

Studimet e Drinit në mënyrë të organizuar filluan nga specialist shqiptarë qysh me 1951, 1961, 1969 nga inxh. Nuri Dhimma, Petrit Radovicka dhe Emin Musliu.

Me 4 korrik 1969 në Gropa të Poravit, në shtratin e Lumit Drin, filloi punimet sonda e parë.

Në gusht 1971, 3 muaj para inaugurimit të fillimit të punimeve të H/C, u hap traseja e rrugës Dardhë-Fierzë e B. Curr,

për 10 ditë ku morën pjesë 17 000 veta.

Po me 1971 ndërtohen Urat provizore Karmë e Krasniqes- Gropa e Valbonë-Dushaj (kjo e sotmja ekzistuese e vitit 1972).

Inaugurimi i fillimit të punimeve 24 nëntor në Gropa të Poravit.

Devijimi i Drinit - vera e vitit 1974, një gjë e pabesueshme dhe e paparë as në ëndërrta më të guximshme, por tashmë e bërë realitet, dëshmitarë okularë i së cilës më rastisi të jem edhe unë (Në nëntor 1978 filloi shfrytëzimi i H/C me dy agregat).

Familja Markokaj, dëshmitarë e gjithë këtyre ngjarjeve me rëndësi, por edhe i sa e sa të tjerave, që nuk mund të përmen-den në këtë shkrim. Ajo u bë shembull i një sjellje të kulturuar emancipuese, i një komunikimi e të gjenduri përsëri pranë njerëzve e nevojtar të shumtëve, ndonëse kishte edhe disa arritje, por prape drejt-heshin tek kjo familje për t'i orientuar e sqaruar të sapo ardhurit për adresat, kantieret, personat zyrtarë e jo zyrtarë, objektet social-kulturore e të tjera.

Kjo familja, shumë prej tyre, ndoshta më shumë se me qindra, i ka njohur e me dhjetëra i ka pasur miq në shtëpinë e vogël, po me zemër të madhe. Ata kishin shumë nevoja për gjërat më të thjeshta në dukje e deri ato më me rëndësi; u dukej se kishin

neutralizues u zbulua me 4 here të paktën 6 muaj mbas dozës së dyte, sipas një studimi Izraelit i publikuar me 9 dhjetor në revistën NEJM. Megjithatë mbrojtja në kushtet e spitalit mbetet e larte pas 6 muajve- 89%e Pfizer dhe 94%e modernes. Kjo tregon se mbrojtja kundër formave

ardhur në një planet tjetër, në një vend të largët e të panjohur, me një barrë të rëndë plot nevoja e të tjera akoma më të rëndë, që e kishin lënë në shtëpitë e rrethet nga kishin ardhur. Ishte një balsam e antistres, kur u shpjegonin për traditat e çmuara të Tropojës, për respektin që kanë për çdo mik e të ardhur nga larg, për klimën e mirë e ajrin e pastër e të tjera gjëra që i provuan më vonë. Shumë mirënjohje e fjalë të mira u thanë e thuhën edhe për ato vite, ku po veçojmë edhe mirënjohjen e mësuesëve të ardhura nga Fieri në vitet 1968 e 1970 që shërbyen me shumë përkushtim jo vetëm si mësues, por edhe për zhvillimin e emancipimin e mjedisit ku jetonin.

Gjoni në dekadën e fundit punoi mësues në Shkollën 9- vjeçare e të Mesme, çka u lidhë edhe më afër me bashkësinë ku banonte. Shumë emra mësuesish e nxënësish përmend, por për harresa të momentit plotësojnë ish nxënës të atyre viteve ku përfshihen edhe fëmijët e mësuesit.

Shpopullimi ndihet edhe këtu, por ndjehet edhe tendenca e interesimi për ripopullim, për rregullimin e restaurimin e shtëpive, për shfrytëzimin e vendosjen nën kulturë të shumë tokave të lëna djerrë prej vitesh, por me një qëndrim përbuzës ndaj traditës së mbajtjes së bagëtive.

Këto që thamë janë një pjesë e vogël e

vlerave të shumta të krahinës, përgjithësisht me tendencë pozitive në rritje, çka shihet në administratën e Njësisë Administrative, në punonjësit e tjerë publik e privat, për një shërbim sa më të kulturuar, për ruajtjen e rritjen e interesit për shkolim, për unitetin, për urat e komunikimit e një harmoni reale e të qëndrueshme.

Shumë shembuj pozitiv i kemi mes nesh, por shpesh nuk i shohim e vlerësojmë; ata duhen njohur, evidentuar, shtuar, promovuar e marrë shembull frymëzimi për sot për nesër.

Edhe diçka tjetër domethënëse. Kjo familje e lideri i saj, me vizionin bashkëkohorë që kanë, nuk kanë ngritur mure, parcelizime e bunkerë mes periudhave historike të hershme, të vona apo të sotme, mes shtresash shoqërore me diversitet mendimesh, idesh e qëndrimesh, partish e shoqatash, krahinash e fshattrash, por, edhe këtu, kanë ndërtuar ura komunikimi e mbjellë dashuri duke gjykuar pozitivisht, respektuar e çmuar tek secili, ato vlera që i shërbejnë përparimit e ecjes përpara.

Në mbyllje dua të shtoj se, po të kërkoja mendimin e tyre, me siguri do të më kundërshtonin modestish e prerë për publikimin e këtij shkrimi.

Frrak Vukaj

REDAKSIA

Kryeredaktore: **LUIGJ SHYTI**

Prelë Milani, Lazer Stani, Roza Pjetri, Lazer Kodra, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja, Age Martini, Klodjana Serraj, Vilsan Peshkaj, Marjan Ndershtiqaj, Arber Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza, Ndue Ziçi, Gazper Marku, Mark Gjeka.

**Mundësoi Botimin:
Ermal Shytani - Angli**

